

Mekanizmi i Pavarur i Raportimit

Raporti i Rezultateve:
Kosova 2023-2025

Open
Government
Partnership



Independent
Reporting
Mechanism

Pasqyra e Lëndës

Përmbledhja Ekzekutive	2
Kreu I. Vëzhgimet kryesore	4
Kreu II. Rezultatet fillestare	8
Kreu III. Pjesëmarrja dhe bashkëkrijimi	12
Kreu IV. Metodologjia	16
Shtojca I. Të dhëna për zotimet	18

Përmbledhja Ekzekutive

Plani i parë i veprimit i Kosovës për PQH-në (2023–2025) çoi në përmirësimin e transparencës së rekrutimit të zyrtarëve të lartë. Sidoqoftë, pjesa më e madhe e zotimeve të tjera u përmbushën në një shkallë të kufizuar. Plani i veprimit u bashkëkrijua nëpërmjet një procesi të hapur dhe gjithëpërfshirës, por fazës së zbatimit i mungoi bashkërendimi i qendëruar dhe angazhimi i aktorëve. Planet e ardhshme të veprimit mund të kenë nevojë për infrastrukturë më sistematike të PQH-së dhe për partneritet më të strukturuar me shoqërinë civile për krijimin dhe zbatimin e përbashkët të zotimeve.

Zbatimi

Plani i veprimit i Kosovës për periudhën 2023–2025 përmbante 13 zotime që shtriheshin në fushat e qeverisjes digjitale, të dhënave të hapura, pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, hapësirës civile, prokurimit publik dhe transparencës së financave politike. Zotimi 4.2 (rekrutimi transparent i zyrtarëve të nivelit të lartë) u përmbush në masë të konsiderueshme. Ky zotim çoi në një kornizë ligjore të re dhe platforma qendrore për menaxhimin e burimeve njerëzore ndihmoi në arritjen e një procesi rekrutimi më të standardizuar, me njoftime publike për vendet e lira, si edhe aplikime online. Sidoqoftë, vijoi të kishte raste të mungesës së transparencës (p.sh. mosbërja publike e pikëzimit nga paneli dhe praktika jo të njëtrajtshme shpjegimi), garancitë për integritetin nuk u institucionalizuan sipas parashikimit dhe mbështetja tek praktika e emërimit të ushtruesve të përkohshëm të detyrave e kufizoi aftësinë e reformave për të rritur besimin e publikut dhe llogaridhënien.

Zotimet e tjera patën ecuri të pabarabartë; disa përparuan pjesërisht, ndërsa të tjerat mbetën të bllokuara. Shumë prej zotimeve që kishin të bënin me platformat digjitale, si portali kombëtar i të dhënave të hapura (Zotimet 2.1-2.4) dhe portali e-Komunat (Zotimi 1.2), u ndikuan nga kapacitetet e pabarabarta teknike dhe njerëzore në qeveri, si edhe nga problemet me funksionimin e platformave. Dy zotimet e identifikuar si më ambiciozet në Vlerësimin e Planit të Veprimit të MPR-së (Zotimi 4.1 për transparencën e prokurimit publik dhe Zotimi

Një vështrim i shpejtë

NIVELI I PËRMBUSHJES

1/13

Zotime të përmbushura plotësisht ose në nivel të konsiderueshëm

REZULTATET FILLESTARE

1/13

Zotime me rezultate fillestare

0/13

Zotime me rezultate të rëndësishme

VËZHGIMET KRYESORE

- Procesi shumë i mirë i bashkëkrijimit i Kosovës nuk u pasua me një proces po aq të mirë zbatimi për shkak të mungesës së infrastrukturës së PQH-së
- Paqëndrueshmëria politike e ngushtoi mundësinë për reforma qeverisëse dhe çoi në vonesa në fazën e zbatimit
- Pati përmirësime teknike, por shpesh pa një strategji koherente që këto përmirësime të sillnin rezultate nga qeverisja e hapur
- Kontributi i shoqërisë civile e forcoi fazën e zbatimit, duke shkuar përtej përputhshmërisë formale me zotimet
- Reformat ambicioze kërkojnë një planifikim realist hapash, veçanërisht për zotimet që varen nga miratimi i ligjeve

A u përmbushën kërkesat minimale gjatë zbatimit: Jo

4.3 për transparencën e financave politike) vareshin nga miratimi i legjislacionit dhe nuk përparuan për shkak të mungesës së një Kuvendi funksional gjatë pjesës më të madhe të periudhës së zbatimit. Për më tepër, zbatimi u kufizua edhe nga mungesa e gjatë e bashkërendimit të planit të veprimit në nivel qendror.

Pjesëmarrja dhe bashkëkrijimi

Kosova e bashkëkrijoi planin e parë të veprimit nëpërmjet një procesi gjithëpërfshirës, me një forum shumëpalësh (Komiteti Kombëtar i Bashkërendimit - KKB), me tryeza pune të shumta, me diskutime publike dhe me një konsultim të gjerë online. Shoqëria civile raportoi gjerësisht se komentet e tyre ishin pasqyruar në planin përfundimtar, falë edhe angazhimit aktiv të Pikës së Kontaktit gjatë procesit të bashkëkrijimit. E kundërta ndodhi gjatë zbatimit, ku pjesëmarrja u ndërpre ose mbeti në vend. Pas miratimit të planit, Kosova funksionoi për një periudhë të gjatë kohe pa pikë kontakti aktive në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), KKB-ja nuk u mbledh gjatë fazës së zbatimit dhe nuk pati komunikim apo raportim sistematik ndaj shoqërisë civile. Faqja e dedikuar e internetit e PQH-së, e cila fillimisht u mirëmbajt nga shoqëria civile, nuk u përditësua gjatë fazës së zbatimit dhe mbeti jofunksionale edhe pasi u transferua teknikisht tek qeveria. Si rezultat, nuk pati një vend ku të ruheshin provat, dokumentet dhe informacioni për gjurmimin e ecursë së procesit. Rrjedhimisht, Kosova nuk arriti të përmbushte kriteret minimale të përcaktuara në Standardet e PQH-së për Pjesëmarrje dhe Bashkëkrijim. Në qershor të vitit 2025, MAPL-ja krijoi një strukturë të dedikuar për PQH-në, e cila udhëhoqi procesin e hartimit të Planit të ri të Veprimit për periudhën 2026-2028 dhe pritet të fuqizojë vijimin e bashkërendimit, të mundësojë dialog më të rregullt të aktorëve dhe të përmirësojë gjurmimin dhe raportimin në lidhje me fazën e zbatimit.

Konteksti i Zbatimit

Zbatimi në Kosovë u zhvillua në një mjedis politik kompleks dhe të paqëndrueshëm. Konteksti i vitit 2024 u karakterizua nga rritja e tensioneve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ngecja e proceseve ndërkombëtare dhe integritetit në BE, si dhe nga debati publik i dominuar nga çështjet e sigurisë, çka e uli vëmendjen e politikës ndaj reformave qeverisëse. Në vitin 2025, zgjedhjet e përsëritura dhe paralizimi institucional e vështirësuan edhe më shumë zbatimin e reformave. Vonesat e zgjatura në konstituimin e Kuvendit, qeveria në detyrë me kompetenca të kufizuara dhe përsëritja e cikleve zgjedhore e zvogëluan hapësirën për bashkërendim institucional dhe për vijimësi të qëndrueshme në zbatimin e politikave. Këto dinamika çuan në përmbushje të fragmentuar të zotimeve nga ana e institucioneve dhe kufizuan mundësitë për monitorim të strukturuar dhe llogaridhënie nga palët e interesuara.

Kreu I. Vëzhgimet kryesore

Vëzhgimet kryesore të mëposhtme përmbajnë reflektime nga cikli i planit të parë të veprimit të Kosovës. Këto mësimë kanë për qëllim të mbështesin planet e ardhshme të veprimit të Kosovës dhe të zgjerojnë rrugëtimin e qeverisjes së hapur.

Vëzhgimi 1: Procesi shumë i mirë i bashkëkrijimit i Kosovës nuk u pasua me një proces po aq të mirë zbatimi për shkak të mungesës së infrastrukturës së PQH-së

Plani i parë i veprimit i Kosovës për PQH-në nisi me një vrull të madh. Aktorët e shoqërisë civile e përshkruan fazën e bashkëkrijimit si të hapur dhe gjithëpërfshirëse, me një forum aktiv shumëpalësh, me takime dhe konsultime të shpeshta, si dhe me perceptimin se kontributet e tyre u pasqyruan në planin përfundimtar.¹ Ky sukses u mbështet nga një nivel i lartë përkushtimi personal nga Pika e Kontaktit (PK), i cili, si këshilltar politik, udhëhoqi procesin e anëtarësimit të Kosovës në PQH dhe bashkëkrijimin e planit të parë të veprimit.² Sidoqoftë, faza e zbatimit nuk arriti ta ruante vrullin fillestar. Pak kohë pasi qeveria miratoi planin e veprimit në dhjetor të vitit 2023, Kosova funksionoi për gati një vit pa PK, deri në fund të vitit 2024 (për rreth gjysmën e fazës së zbatimit). Forumi shumëpalësh nuk u mblodh përgjatë periudhës së zbatimit (dhjetor 2023-dhjetor 2025). Gjithashtu, MAPL-ja nuk e përditësoi faqen e internetit të PQH-së së Kosovës (e cila u zhvillua nga shoqëria civile gjatë bashkëkrijimit) përgjatë fazës së zbatimit, duke kufizuar mundësitë për monitorimin e ecurisë së zotimeve.³ Korniza e plotë institucionale u plotësua brenda qershorit të vitit 2025 me krijimin e një strukture të posaçme për PQH-në brenda MAPL-së.⁴

Cikli i planit të parë të veprimit tregoi se Kosova e ka aftësinë, si nga ana e qeverisë edhe nga ajo e shoqërisë civile, për të organizuar një proces PQH-je gjithëpërfshirës dhe konstruktiv. Megjithatë, për ta ruajtur këtë qasje, procesi i PQH-së duhet të institucionalizohet përmes strukturave, roleve dhe praktikave të qarta të punës. Një gjë e tillë do ta mbronte më shumë zbatimin e planit të veprimit nga paqëndrueshmëritë politike dhe nga ndryshimet apo largimet e personelit në institucionet qeveritare. Plani i dytë i veprimit i Kosovës për periudhën 2026–2028 i përgjigjet kësaj nevojë duke përfshirë një zotim për institucionalizimin e strukturave të PQH-së dhe forcimin e procesit të zbatimit nëpërmjet një bashkërendimi dhe monitorimi më të mirë.⁵

Vëzhgimi 2: Paqëndrueshmëria politike e ngushtoi mundësinë për reforma qeverisëse dhe çoi në vonesa në fazën e zbatimit

Plani i veprimit i Kosovës përkoi me një periudhë luhatjesh politike, duke përfshirë edhe ngrirjen e aplikimit të Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës në maj të vitit 2024⁶ dhe pothuajse bllokimin e dialogut Kosovë-Serbi të ndërmjetësuar nga BE-ja.⁷ Zgjedhjet për Kuvendin të shkurtit të vitit 2025, të planifikuara shumë kohë më parë, bënë që partitë politike, që prej verës së vitit 2024, t'u jepnin përparësi strategjive zgjedhore dhe jo hartimit të politikave, duke zvogëluar hapësirën për reforma të qeverisjes së hapur. Pas zgjedhjeve, Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk arriti të konstituohej,⁸ duke çuar në një qeveri në detyrë nga marsi i vitit 2025 deri në mbajtjen e zgjedhjeve të reja për Kuvend në dhjetor të vitit 2025.⁹ Zgjedhjet lokale në vjeshtë të vitit 2025 e larguan edhe më shumë vëmendjen e vendimmarrësve dhe atë të publikut nga reformat.¹⁰ Kjo paralizë ndikoi në ciklin e PQH-së, pasi për një periudhë të gjatë mungoi koordinimi gjatë zbatimit. Për ciklet e ardhshme të planeve të veprimit, zotimet e PQH-së mund të përfshihen në planet dhe buxhetet vjetore të punës, për të zbutur ndikimin e

krizave të ngjashme politike. MPR-ja rekomandon gjithashtu ndërmarrjen e hapave për institucionalizimin e punës së forumit shumëpalësh dhe të rolit të PK-së në mënyrë që procesi i PQH-së të ndikohet më pak nga ndryshimet politike apo institucionale.

Vëzhgimi 3: Pati përmirësime teknike, por shpesh pa një strategjie koherente që këto përmirësime të sillnin rezultate nga qeverisja e hapur

Zbatimi i pjesëve të planit të veprimit çoi në përmirësime teknike të platformave digjitale, por pa sjellë ndryshime të rëndësishme në transparencën, llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë e këtyre platformave. Zotimi 1.1 e ilustron këtë hendek: edhe pse në platformën e-Kosova u shtua një seksion i veçantë "Grante dhe Subvencione" që sipas raportimeve u përdor shumë, ky seksion nuk përfshinte të gjithë spektrin e granteve dhe subvencioneve qeveritare. Gjithashtu, seksioni kufizohej vetëm tek thirrjet e hapura pa dhënë informacion për publikun për përfituesit, zbatimin apo rezultatet e vlerësimit.¹¹ Po kështu, MAPL-ja zhvilloi një gamë të gjerë modulesh të reja komunale në platformën e-Komunat (Zotimi 1.2), por vetëm disa funksione ishin të dukshme për publikun ose të integruara në punën e zyrtarëve komunalë përgjegjës për shërbimet (p.sh. në mjetet kryesore për qytetarët nuk ka reagime të regjistruara nga komunat).¹² Në fushën e prokurimit publik (Zotimi 4.1), përmirësimet e ndërveprueshmërisë nuk çuan në arritjen e qëllimit kryesor të zotimit: ofrimin e të dhënave të prokurimit "plotësisht të hapura" në formate të lexueshme nga makinat".¹³ Rekrutimi i zyrtarëve të nivelit të lartë (Zotimi 4.2) u lehtësua nga fakti se korniza ligjore dhe platforma e rekrutimit ekzistonin që përpara krijimit të planit të veprimit. Megjithatë, disa elemente të rëndësishme të transparencës, si publikimi i votimit të panelit dhe arsyetimi i standardizuar i vendimeve, si dhe masa e planifikuar për garantimin e integritetit (shqyrtimi sistematik kundër korrupsionit), nuk u zbatuan siç ishte parashikuar.¹⁴

Zotimet e ardhshme të PQH-së që përfshijnë mjete digjitale, mund të nisin nga vlerësimi i nevojave të përdoruesve (qytetarëve, gazetarëve, bizneseve), duke përcaktuar produktet (kush publikon, çfarë publikon, kur, në cilin format dhe për çfarë qëllimi) dhe duke u siguruar që mjetet digjitale t'i shërbejnë qëllimit për ta bërë qeverisjen më transparente, më llogaridhënëse dhe me më shumë pjesëmarrje. MPR-ja rekomandon gjithashtu përfshirjen e shoqërisë civile në monitorimin e këtyre platformave gjatë zbatimit.

Vëzhgimi 4: Kontributi i shoqërisë civile e forcoi fazën e zbatimit, duke shkuar përtej përputhshmërisë formale me zotimet

Pavarësisht mungesës së mbikëqyrjes dhe monitorimit qendror të zbatimit të planit të veprimit, shoqëria civile dha komente që ndihmuan në avancimin e disa prej zotimeve. Për rekrutimin e zyrtarëve të nivelit të lartë (Zotimi 4.2), monitorimi nga shoqëria civile thuhet se ndihmoi në identifikimin e parregullsive dhe kontribuoi në anulimin e procedurave me mangësi.¹⁵ Në fushën e konsultimeve publike, (Zotimi 3.1), shoqëria civile mbështeti përfshirjen e kriterëve të konsultimit në Rregulloren e Punës së Qeverisë. Ndërkaq, monitorimi i tyre nxori në pah hendeqet ndërmjet përmbushjes formale (publikimi i projektakteve) dhe pjesëmarrjes së qenësishme (cilësia e dokumenteve mbështetëse, kthimi i përgjigjeve ndaj kontribuesve dhe publikimi i vazhdueshëm i raporteve përfundimtare të konsultimit).¹⁶ Në lidhje me paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike (nga anglishtja: SLAPP), në kuadër të Zotimit 3.2, shoqëria civile dhe partnerët ndërkombëtarë hartuan materiale udhëzuese dhe doracakë, organizuan diskutime, pilotuan trajnime dhe krijuan mekanizma koordinimi. Megjithatë,

reformat për përafrimin me standardet Anti-SLAPP të BE-së nuk shënuan përparim.¹⁷ Për transparencën e financimit të partive politike (Zotimi 4.3), shoqëria civile vijoi të monitoronte shpenzimet gjatë fushatave përgjatë cikleve zgjedhore të vitit 2025 dhe prodhoi dëshmi që tregojnë se shpenzimet e fushatave po bëheshin gjithnjë e më komplekse (kryesisht online), duke përfshirë shpenzimet që lidhen me kandidatët dhe me disa reklama të palëve të treta, pavarësisht monitorimit të kufizuar institucional të financimit të partive.¹⁸ Këto kapacitete do të mund të shfrytëzoheshin më mirë në ciklet e ardhshme të planeve të veprimit, përmes partneriteteve të strukturuar për përmbushjen e përbashkët të zotimeve, në rastet kur ekziston interes i përbashkët dhe ekspertizë plotësuese.

Vëzhgimi 5: Reformat ambicioze kërkojnë një planifikim realist hapash, veçanërisht për zotimet që varen nga miratimi i ligjeve

Cikli i parë i PQH-së për Kosovën ishte proces i rëndësishëm i të mësuarit institucional në lidhje me hartimin e zotimeve. Disa prej zotimeve u hartuan si paketa reformash të gjera dhe me shumë hapa (p.sh. reforma e prokurimit publik, transparenca e rekrutimit të zyrtarëve të lartë dhe zgjerimi i paketës së shërbimeve elektronike). Megjithatë, në praktikë, përpjekjet shpesh u përqendruan në një apo disa etapa të arritshme, ndërsa elementet më të gjera që lidhen me qeverisjen dhe llogaridhënien mbetën prapa. Kjo çoi në ndryshime të izoluara, por me shtrirje të kufizuar në nivel sistemi (p.sh. ndërveprueshmëria e platformës së prokurimit publik me sistemin e menaxhimit të financave publike, platformën e menaxhimit të burimeve njerëzore, apo një seksion për grantet me numër të kufizuar rastesh të aplikimit online), dhe jo në reforma të plota, nga fillimi deri në fund të procesit, që do të përmirësonin hapjen dhe llogaridhënien.

Disa prej zotimeve më ambicioze vareshin nga miratimi i ligjeve ose i ndryshimeve ligjore si parakusht për zbatimin, veçanërisht në lidhje me prokurimin publik (Zotimi 4.1) dhe transparencën e financimit të partive politike (Zotimi 4.3), si edhe pjesërisht në përafrimin e modaliteteve kundër padive SLAPP me Direktivat e BE-së (Zotimi 3.2). Përgjatë pjesës më të madhe të periudhës së zbatimit, Kosova funksionoi në një mjedis të kufizuar politik dhe institucional, me periudha të gjata të funksionimit të kufizuar të Kuvendit dhe me qeveri në detyrë. Për pasojë, zotimet që vareshin nga reforma ligjore kishin më pak gjasa të bënin përpara. Në të ardhmen, Kosova mund të vijojë të jetë ambicioze, duke i renditur më mirë reformat, qoftë duke i lidhur zotimet me rrugë legjislative dhe afate të qarta, qoftë duke i shoqëruar reformat ligjore me hapa paralele dhe të realizueshme që mund të arrihen edhe nëse vonohet miratimi i legjislacionit.

Kosova duket se ta filluar tashmë t'i zbatojë disa prej këtyre mësimëve. Plani i dytë i veprimit për periudhën 2026–2028 është më i përqendruar tek zbatueshmëria në praktikë, duke e ulur numrin e zotimeve në katër fusha strategjike dhe një zotim shtesë të fokusuar te procesi.¹⁹ Plani gjithashtu siguron vazhdimësi në fusha të caktuara, si qeverisja digjitale në nivel lokal dhe pjesëmarrja e qytetarëve përmes platformës e-Komunat, si dhe përpjekjet për përmirësimin e qasjes në informacion, standardizimin e të dhënave të hapura dhe publikimin proaktiv.

¹ Blerta Thaçi (Open Data Kosova – ODK), intervistë me MPR-në, 25 mars 2026; Diana Metushi Krasniqi (Instituti Demokratik i Kosovës – IDK), intervistë me MPR-në, 6 prill 2026; Valmir Gashi (Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale – KLGI), intervistë me MPR-në, 31 mars 2026.

² Fidan Kalaja (ish-Pika e Kontaktit për Kosovën gjatë procesit të bashkëkrijimit), intervistë me MPR-në, 30 mars 2026.

³ Blerta Thaçi (Open Data Kosova – ODK), intervistë me MPR-në, 25 mars 2026; Diana Metushi Krasniqi (Instituti Demokratik i Kosovës – IDK), intervistë me MPR-në, 6 prill 2026.

⁴ Flurim Arifi (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal – MAPL dhe Pika e Kontaktit të PQH-së për Kosovën), intervistë me MPR-në, 24 mars 2026.

⁵ Partneriteti për Qeverisje të Hapur, Plani Kombëtar i Veprimit i Kosovës 2026–2028, https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2026/04/Kosovo_Action-Plan_2026%E2%80%932028_EN.pdf

⁶ Euronews, Përse drita e gjelbër për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës ka të ngjarë të shtyhet, 9 maj 2024, <https://www.euronews.com/2024/05/09/why-the-green-light-for-kosovo-joining-the-council-of-europe-is-likely-to-be-delayed>

⁷ Gentiana Paçarizi - Kosova 2.0, Ku po shkon dialogu, 14 prill 2026, <https://kosovotwopointzero.com/en/where-is-the-dialogue-heading>

⁸ Radio Evropa e Lirë, Kosova përballet me thellim të krizës politike pas 21 përpjekjeve të pasuksesshme për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, 26 maj 2025, <https://www.rferl.org/a/kurti-kosovo-speaker-parliament-bajrami-haxhiu/33423764.html>

⁹ Reuters, Presidentja e Kosovës cakton 28 dhjetorin si datën e zgjedhjeve të parakohshme, 20 nëntor 2025, <https://www.reuters.com/world/kosovo-president-sets-dec-28-date-snap-vote-2025-11-20/>

¹⁰ Presidentja e Kosovës, Presidentja Osmani ka caktuar datën 12 tetor 2025 për organizimin e zgjedhjeve lokale të rregullta, 9 qershor 2025, <https://president-ksgov.net/en/president-osmani-has-set-october-12th-2025-as-the-date-of-holding-of-regular-local-elections/>

¹¹ Shih Shtojcën I më poshtë: Zotimi 1.1: Portali i shërbimeve elektronike i Kosovës (e-Kosova)

¹² Shih Shtojcën I më poshtë: Zotimi 1.2: Integrimi i modulit të ri (e-Komunat) brenda e-Kosovës për të digjitalizuar të gjitha shërbimet komunale

¹³ Shih Shtojcën I më poshtë: Zotimi 4.1: Sistem plotësisht i hapur i prokurimit publik

¹⁴ Shih Shtojcën I më poshtë: Zotimi 4.2: Rekrutimi transparent i zyrtarëve të nivelit të lartë

¹⁵ Ema Pula (Grupi për Studime Ligjore dhe Politike – GLPS), intervistë me MPR-në, 3 prill 2026.

¹⁶ Dren Puka (Fondacioni Kosovar për Shoqërinë Civile (FKSC), intervistë me MPR-në, 31 mars 2026.

¹⁷ Burbuqe Kastrati (Lëvizja Fol), intervistë me MPR-në, 1 prill 2026.

¹⁸ Eugen Cakolli (Instituti Demokratik i Kosovës – IDK), intervistë me MPR-në, 1 prill 2026.

¹⁹ Partneriteti për Qeverisje të Hapur, Kosovë, Plani i Veprimit i Kosovës për PQH-në 2026-2028, mars 2026, https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2026/04/Kosovo_Action-Plan_2026%E2%80%932028_EN.pdf

Kreu II. Rezultatet Fillestare

Në këtë pjesë analizohen ato zotime që shënuan rezultatet fillestare më të mira në kuadër të planit të veprimit. Për vlerësimin e rezultateve fillestare, MPR-ja merr parasysh objektivat e zotimeve, kontekstin e vendit, fushën përkatëse të politikave dhe dëshmitë që tregojnë nëse ka pasur ndryshime. Vlerësimi i rezultateve fillestare nga MPR-ja përcaktohet nga niveli i ndryshimeve të arritura dhe nga dëshmitë që tregojnë se ky ndryshim pritet të ruhet me kalimin e kohës.

Tabela 1. Zotimet me Rezultate Fillestare

Zotimi 4.2: Ky zotim çoi në një kornizë ligjore të re dhe platforma qendrore për menaxhimin e burimeve njerëzore ndihmoi në arritjen e një procesi rekrutimi më të standardizuar, me njoftime publike për vendet e lira, si edhe aplikime online.

Zotimi 4.2: Rekrutimi transparent i zyrtarëve të nivelit të lartë

Zbatuesit: Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)

Aktorët mbështetës: Kuvendi, Komisionet Parlamentare, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, Organizatat e Shoqërisë Civile

Konteksti dhe Objektivat

Axhenda e Kosovës për reformën e administratës publike ka treguar vazhdimisht dobësi në rekrutimin e bazuar në transparencë dhe meritë në qeveri, veçanërisht për pozitat e larta/drejtuese. Ligji i vitit 2020 për Zyrtarët Publikë nuk është zbatuar në mënyrë të efektshme, pasi nuk ka një sistem të centralizuar të rekrutimit të bazuar në meritë, ka përdorim të gjerë të pozitave me ushtruesve të detyrës, veçanërisht për pozitat e larta drejtuese, dhe procedurat e rekrutimit nga jashtë strukturave janë joefektive. Edhe pse publiku mundet të kishte qasje në disa informata mbi procesin e rekrutimit, sistemet e transparencës dhe menaxhimit të burimeve njerëzore (MBNJ) mbetën të dobëta.¹

Zotimi 4.2 synonte të rriste hapjen dhe integritetin e rekrutimeve për pozitat e larta shtetërore. Ky zotim parashihte standardizimin dhe unifikimin e procedurave të rekrutimit, zhvillimin e një platforme funksionale online për rekrutimin, si dhe publikimin e votimit të panelit intervistues dhe dhënien e arsyetimeve me shkrim për pikëzimin. Zotimi parashikonte edhe një garanci të shtuar për integritetin, me dërgimin e listës së kandidatëve që përmbushin kriteret formale tek Agjencia Anti-Korrupsion për mendim ligjor për raste të mundshme të konfliktit të interesit—me qëllim për t'i bërë proceset e rekrutimit më transparente, llogaridhënëse dhe më të qëndrueshme ndaj rrezeve të politizimit të cilat ishin identifikuar gjatë vlerësimeve të reformave të mëparshme.

Rezultatet fillestare: Rezultate të moderuara

Provat tregojnë se ky zotim pati rezultate fillestare të moderuara për hapjen e qeverisjes. Ligji i ri për Zyrtarët Publikë², në fuqi që prej shtatorit të vitit 2023, dhe rregullorja përkatëse për pranimin në shërbimin civil³ ofrojnë një kornizë ligjore dhe rregullatore të standardizuar për rekrutimin e pozitave të larta shtetërore. Rekrutimi mbështetet nga sistemi qendror i informacionit për Burimet Njerëzore (SIMBNJ) për botimin e vendeve të lira, mundësimin e

aplikimeve online dhe menaxhimin e të gjitha fazave të procesit.⁴ Përgjatë periudhës 2024-2025, procedurat e rekrutimit u decentralizuan për një periudhë kalimtare pasi hyri në fuqi ligji i ri dhe proceset e rekrutimit u menaxhuan nga njësitë BNJ të institucioneve.⁵ Sidoqoftë, decentralizimi u karakterizua nga mungesa e efikasitetit dhe nga përdorimi i gjerë i ushtruesve të detyrës, duke vonuar përfundimin e proceseve të rekrutimit.⁶ Sistemi iu kthye përsëri modelit të qendëruar në mars të vitit 2025.⁷ Mbështetja për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit (SIGMA) vëren se mandati i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë (DMZP) i Ministrisë së Punëve të Brendshme u kufizua prej një vendimi të Gjykatës Kushtetuese, duke iu hequr e drejta për të kërkuar dhe marrë informacione që lidhen me zbatimin e detyrave të veta, si edhe funksioni për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit.⁸ Duke pasur parasysh rolin qendror bashkërendues të DMZP-së për rekrutimin e zyrtarëve të lartë, ky vendim mund të ketë ndikuar negativisht në zbatimin e këtij zotimi.

Korniza ligjore kërkon që të gjithë zyrtarët e lartë të rekrutohen përmes një procedure të unifikuar, të bazuar në shpalljen e vendit vakant, në një sistem vlerësimi me dy faza dhe në një komision rekrutimi të ngritur posaçërisht. Informatat për rezultatet u publikuan në platformën e SIMBNJ-së. Hapja e këtyre pozitave për kandidatë nga jashtë shënon përpjekjen e parë të strukturuar në Kosovë për të rritur konkurrencën dhe për të tërhequr profesionistë të rinj në shërbimin civil. Sidoqoftë, shoqëria civile raporton se ky ndryshim nuk ka çuar në rritje të konsiderueshme të numrit të aplikuesve dhe as në përzgjedhje të kandidatëve nga jashtë për pozita të larta.⁹ Nga ana tjetër, ka vështirësi në zbatim dhe mangësi në transparencë. Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën, 2025, thekson se sistemi merit i rekrutimit vijon të jetë i paefektshëm dhe i vonuar, ku shumë emërime të ushtruesve të detyrës në nivelet e larta dhe të mesme minojnë stabilitetin, rrisin shqetësimin për politizim, përparim të kufizuar në karrierë dhe për stabilitetin e shërbimit civil.¹⁰ Shoqëria civile thekson nevojën për planifikim më të mirë, përmirësim të bazës së pyetjeve në provimet me shkrim dhe trajnim të vazhdueshëm dhe standardizim të komisioneve rekrutuese të posaçme.¹¹ Shqetësimi më i dallueshëm ka të bëjë me fenomenin e përhapur të ushtruesve të detyrës për pozicionet e larta drejtuese: sipas raporteve të qeverisë për burimet njerëzore, në vitin 2024, 72 përqind e pozicioneve të larta drejtuese mbaheshin nga ushtruesit e detyrës.¹² Sipas raporteve të shoqërisë civile, norma ka vijuar të jetë e ngjashme në vitin 2025 si pasojë e mosshpalljes së vendeve të lira, mungesës së kandidatëve të kualifikuar ose mungesës së kandidatëve në përgjithësi, apo prej anulimit të proceseve të rekrutimit për arsye ligjshmërie.¹³ Përveç kësaj, shoqëria civile vëren se në vitin 2025 pati kufizim të veprimtarisë së rekrutimit si pasojë e qeverisë në detyrë, duke zgjatur përdorimin e ushtruesve të detyrës dhe duke ngadalësuar reformat në praktikë.¹⁴

Në vitin 2024, SIMBNJ-ja ishte plotësisht funksionale dhe publikoheshin të dhënat përkatëse, duke përfshirë vendet e lira të punës, rezultatet e verifikimit paraprak, rezultatet e vlerësimit të fundit dhe njoftimet zyrtare për kandidatët e përzgjedhur për fazën e radhës, ndryshimet e mundshme të afateve të procesit dhe vendimet përfundimtare.¹⁵ Qeveria theksoi anonimitetin e provimit me shkrim, publikimin e listës përfundimtare të fituesve dhe rezultatet nëpërmjet SIMBNJ-së.¹⁶ Sidoqoftë, sipas shoqërisë civile, transparenca është e kufizuar sepse emrat e kandidatëve zëvendësohen nga kode të gjeneruara nga sistemi dhe botohen vetëm pikët e plota dhe jo pikët e dhëna individualisht nga secili anëtar i panelit. Shoqëria civile vëren më tej mungesën e një formati të unifikuar për argumentimet me shkrim të pikëzimit, çka çon në praktika jo të njëjta.¹⁷ Këto kufizime tregojnë se zotimi ka çuar në ndryshime të nivelit mesatar të transparencës krahasuar me situatën përpara planit të veprimit (dhjetor 2023).

Korniza ligjore u dha të drejtën edhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC-ve) dhe sindikatave të monitorojnë procedurat e rekrutimit. Në praktikë, OSHC-ve u lejohet përgjithësisht t'i vëzhgojnë këto procese, ndonjëherë me ftesë nga institucioni, edhe pse janë raportuar raste të izoluar kur nuk iu është lejuar të monitorojnë asnjërën prej fazave.¹⁸ Në periudhën shkurt 2024 dhe shkurt 2025, një koalicion i shoqërisë civile monitoroi 48 procedura rekrutimi për pozita të larta dhe raportoi se kjo mbikëqyrje kishte ndihmuar përmirësimin e proceseve në fjalë, duke përfshirë këtu edhe anulimin e tetë procedurave për arsye të parregullsive.¹⁹

Megjithëse Ligji për Zyrtarët Publik përcakton se integriteti i kandidatëve për pozita të larta është kusht thelbësor, nuk ka ndonjë mekanizëm detyrues proaktiv që t'i kërkojë Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit të nxjerrë opinione për konfliktin e interesit të kandidatëve që i plotësojnë kriteret. Megjithatë, institucionet mund ta kërkojnë një opinion të tillë rast pas rasti dhe raportohet se ka struktura që e bëjnë rregullisht një gjë të tillë (p.sh. këshillat gjyqësore/prokuroriale).²⁰

Në përgjithësi, Kosova ka zhvilluar një kornizë ligjore më të konsoliduar dhe një portal online funksional për publikimin e vendeve të lira dhe për menaxhimin e aplikimeve. Sidoqoftë, zotimi ende duhet të japë rezultate me vlerë në lidhje me transparencën e vendimeve përzgjedhëse dhe kontrollin e parashikuar të integritetit. Gjithashtu, përdorimi më i gjerë i ushtruesve të detyrës ka kufizuar rezultatet e prekshme fillestare për llogaridhënie dhe besimin e publikut.

Vështrimi nga e ardhmja

Edhe pse plani i dytë i veprimit të Kosovës për periudhën 2026–2028 nuk përmban ndonjë zotim për rekrutimin e pozitave të larta, kjo fushë vijon të ketë vlerë për parimet e qeverisjes së hapur. Duke u bazuar tek korniza ligjore ekzistuese dhe tek platforma funksionale, MPR-ja rekomandon që Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike, e krijuar rishtazi, të shqyrtojnë ndërmarrjen e hapave të mëposhtme:

- **Plotësimin e mangësive në transparencën e SIMBNJ-së** duke publikuar (të paktën) pikëzimet e anëtarëve të panelit dhe duke kërkuar argumentime të standardizuara me shkrim për pikët e dhëna, si fusha/shabllone të detyrueshme brenda platformës.
- **Institucionalizimin e garancisë së integritetit** duke krijuar një hap të qartë dhe të detyrueshëm për t'i kërkuar Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit opinione për rrezikun e konfliktit të interesit për kandidatët që përmbushin kriteret formale (duke nisur me rreziqet më të mëdha/me rolet më të larta), ose duke integruar SIMBNJ-në në sistemet e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për identifikimin e rreziqeve në bazë të disa treguesve të integritetit të përcaktuara me kujdes.
- **Përmirësimin e orientimit dhe mbikëqyrjes qendrore** të rekrutimit për pozitat e larta, duke u siguruar që organi përgjegjës qendror të ketë mandat dhe kapacitet të plotë për të kërkuar dhe për të marrë informatat e nevojshme, monitorimin e përputhshmërinë dhe ndërhyrjen në rastet kur procedurat vonohen ose anulohen në mënyrë të përsëritur. Kjo merr rëndësi të veçantë po të kemi parasysh numrin e lartë të ushtruesve të detyrës dhe kufizimet e funksioneve të mbikëqyrjes qendrore.
- **Profesionalizimin e komisioneve dhe instrumenteve përzgjedhëse** me anë të trajnimeve të vazhdueshme dhe standardizimit të komisioneve të posaçme (duke përfshirë edhe protokollet e intervistave) dhe duke pasur një bazë të mirë pyetjesh të provimeve me shkrim për të ulur gabimet dhe mungesën e njëtrajtshmërisë ndërmjet procedurave.

- **Zgjerimin e angazhimit me shoqërinë civile** duke shkuar përtej konsultimeve rast pas rasti drejt përfshirjes sistematike në hartimin e reformave dhe në monitorim të pavarur. Një mënyrë mund të jetë kthimi i OSHC-ve në vëzhgues të përhershëm në të gjitha fazat e rekrutimit, duke krijuar kanale të qarta për raportimin e parregullsive dhe ndjekjen në vijim, si edhe duke publikuar rregullisht gjetjet e grumbulluara të monitorimit dhe veprimet korrigjuese. Për ta arritur këtë në shkallë të gjerë, institucionet përkatëse mund të organizojnë mbështetje financiare të posaçme për mbulimin e kostove të monitorimit të të gjitha proceseve të rekrutimit të niveleve të larta (p.sh. nëpërmjet granteve transparente dhe konkurruese prej një linje buxhetore të posaçme), së bashku me garanci për të mbrojtur pavarësinë dhe për të parandaluar ndikimet në gjetjet e monitorimeve ose në rezultatet e rekrutimit.

¹ Komisioni Evropian, Raporti i BE-së për Kosovën 2023, https://enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2023_en

² Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr.08/L-197 Për Zyratë Publike, 18 shtator 2023, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=81430>

³ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Rregullore (QRK) - Nr.07/2025 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, 9 janar 2026, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=115096>

⁴ Sistemi Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore – SIMBNJ, konkursi.rks-gov.net

⁵ Arlinda Kamberaj (Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike – MDAP), korrespondencë me MPR-në, 8 prill 2026.

⁶ Ema Pula (Grupi për Studime Ligjore dhe Politike – GLPS), intervistë me MPR-në, 3 prill 2026.

⁷ Arlinda Kamberaj (Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike – MDAP), korrespondencë me MPR-në, 8 prill 2026.

⁸ SIGMA – OECD, Administrata publike në Kosovë, 2024, Vlerësim kundrejt Parimeve të Administratës Publike, 2025, https://www.oecd.org/content/dam/oecd/en/publications/reports/2025/01/public-administration-in-kosovo-2024_d9378da9/a53fce6b-en.pdf

⁹ Ema Pula (Grupi për Studime Ligjore dhe Politike – GLPS), intervistë me MPR-në, 3 prill 2026.

¹⁰ Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën, 2025, 4 nëntor 2025, https://enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2025_en

¹¹ Ema Pula (Grupi për Studime Ligjore dhe Politike – GLPS), intervistë me MPR-në, 3 prill 2026.

¹² Ministria e Punëve të Brendshme, Raporti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, 2024, shtator 2025, <https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/EN/9318/ang.%20Raporti%20p%C3%ABr%20Menaxhimin%20e%20Burimeve%20Njer%C3%ABzore%202024%20Shtator%202025.pdf>

¹³ Grupi për Studime Ligjore dhe Politike – GLPS, Ushtruesit e Detyrës: Nga Fenomen në Abuzim, Dokument Politikash, janar 2026, <https://legalpoliticalstudies.org/wp-content/uploads/2026/01/GLPS-Policy-Brief-Acting-Appointments-from-phenomenon-to-abuse.pdf>

¹⁴ Ema Pula (Grupi për Studime Ligjore dhe Politike – GLPS), intervistë me MPR-në, 3 prill 2026.

¹⁵ Sistemi Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore – SIMBNJ, konkursi.rks-gov.net

¹⁶ Arlinda Kamberaj (Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike – MDAP), korrespondencë me MPR-në, 8 prill 2026.

¹⁷ Ema Pula (Grupi për Studime Ligjore dhe Politike – GLPS), intervistë me MPR-në, 3 prill 2026.

¹⁸ Ema Pula (Grupi për Studime Ligjore dhe Politike – GLPS), intervistë me MPR-në, 3 prill 2026.

¹⁹ Grupi për Studime Juridike dhe Politike - GLPS, Instituti GAP dhe Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP, Raporti Vjetor i Corrwat-it, shkurt 2024 – shkurt 2025, mars 2025, <https://corrwat.org/wp-content/uploads/2025/03/Annual-Report-24-25-SHQ.pdf>

²⁰ Yll Buleshkaj (Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit – APK), intervistë me MPR-në, 3 prill 2026.

Kreu III. Pjesëmarrja dhe bashkëkrijimi

Plani i veprimit të Kosovës për periudhën 2023–2025 u zhvillua me pjesëmarrje aktive të shoqërisë civile nëpërmjet takimeve, punëtorive tematike dhe diskutimeve publike, paralelisht me forumin shumëpalësh (Komiteti Kombëtar i Bashkërendimit - KKB). E kundërta ndodhi gjatë fazës së zbatimit, ku edhe pjesëmarrja mbeti në vend, nuk u zhvilluan takime të KKB-së, nuk u ndanë informacione dhe nuk pati përfshirje të shoqërisë civile.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) udhëheq procesin e PQH-së në Kosovë, si në nivelin politik nëpërmjet ministrit, ashtu edhe në nivelin teknik nëpërmjet pikës së kontaktit (PK). Gjatë fazës së bashkëkrijimit, PK-ja ishte këshilltar politik i Ministrit, i cili udhëhiqte si aplikimin e Kosovës për anëtarësi në PQH, ashtu edhe procesin e bashkëkrijimit për planin e veprimit.¹ Pas miratimit të planit të veprimit në dhjetor të vitit 2023, nuk pati PK për gati një vit. Në nëntor të vitit 2024, u emërua PK-ja i ri nga radhët e shërbyesve civilë të lartë. Organizimi institucional u finalizua brenda qershorit të vitit 2025, me krijimin e një strukture të kushtuar PQH-së brenda Departamentit për Digjitalizimin e Shërbimeve Komunale në MAPL.² Mandati i MAPL-së për të krijuar dhe udhëhequr KKB-në për fazën e zbatimit u pohua përsëri nga qeveria në dhjetor të vitit 2023,³ në të njëjtën ditë kur u miratua edhe plani përfundimtar i veprimit. Sidoqoftë, KKB-ja nuk u mbledh gjatë periudhës së zbatimit. Forumi Kombëtar për Qeverisjen e Hapur, forum i ri shumëpalësh, u krijua në fund të vitit 2025.⁴ Ky forum u mbledh disa herë gjatë fundit të vitit 2025 dhe në fillim të vitit 2026 për bashkëkrijimin e planit të dytë të veprimit (2026-2028), i cili u përfundua në mars të vitit 2026.

Një faqe interneti e posaçme (ogpkosovo.org) u zhvillua dhe u menaxhua në mënyrë vullnetare nga OJQ-ja Open Data Kosova (ODK),⁵ dhe shërbeu si burim kryesor informacioni gjatë periudhës së bashkëkrijimit.⁶ Përgjatë periudhës së zbatimit, faqja e internetit nuk u përditësua me informacione dhe prova në lidhje me statusin e zotimeve.⁷ Në vitin 2025, kodi burimor dhe qasja e plotë e administrimit teknik iu transferua MAPL-së, por faqja vijoi të mos ishte funksionale të paktën deri në prill të vitit 2026.⁸ Nuk pati vend tjetër për t'iu qasur dokumenteve për zbatimin dhe as komunikim publik nëpërmjet kanaleve të tjera për ecurinë.

Të intervistuarit nga shoqëria civile dhe nga qeveria sugjeruan që të përmirësohej formati i bashkëpunimit përgjatë planit të dytë të veprimit për periudhën 2026–2028, me angazhim më të hershëm, me strukturë më të qartë (edhe me punë në grupe më të vogla tematike) dhe me më shumë reagime sistematike ndaj komenteve, duke zbatuar mësimet e marra nga cikli 2023–2025.

Bashkëkrijimi i Planit të Veprimit

Siç përmendet në Vlerësimin e Planit të Veprimit të MPR-së, zhvillimi i planit të veprimit të Kosovës për periudhën 2023-2025 pati përfshirje aktive të shoqërisë civile. Kosova e filloi bashkëkrijimin e planit të parë të veprimit përpara anëtarësimit formal në PQH. KKB-ja zhvilloi takimin e parë në tetor 2021,⁹ dhe anëtarësia përbëhej në shumicë nga shoqëria civile. Bashkëkrijimi përfshinte një periudhë fillestare dy-mujore për konsultim në vitin 2022, me 11 takime të KKB-së, katër punëtori tematike dhe shtatë diskutime publike në qendrat kryesore rajonale të Kosovës.¹⁰ Pas një vendimi të Komitetit Drejtues të PQH-së në mars të vitit 2023 për t'u lejuar shteteve joanëtare të OKB-së të bashkohen me PQH-në si anëtarë pa të drejtë vote,

Kosova përmbylli hapat përgatitorë kryesorë për hyrjen në partneritet, si përmbushjen e kriterëve teknike të pranimit, kalimin e Kontrollit të Vlerave dhe përgatitjen e planit përfundimtar të veprimit. Kosova paraqiti dokumentin e shprehjes së interesit më 17 korrik 2023 dhe u pranua si anëtare e PQH-së më 31 korrik 2023. Pasi u konfirmua pranueshmëria e Kosovës, MAPL-ja organizoi një seri të re konsultimesh përgjatë periudhës maj-korrik 2023.¹¹ Përfaqësuesit e shoqërisë civile pohuan se komentet e tyre u morën parasysh dhe u pasqyruan në variantin përfundimtar të planit të veprimit, duke vënë në dukje edhe qasjen pozitive të PK-së përgjatë procesit të bashkëkrijimit.¹² Plani i veprimit u miratua nga Qeveria e Kosovës më 13 dhjetor 2023.¹³

Pjesëmarrja gjatë zbatimit

Pas miratimit të planit të veprimit, pati një mungesë të gjatë të bashkërendimit të procesit të PQH-së nga ana e qeverisë. Kjo ndodhi kryesisht për shkak të një periudhe të zgjatur pa drejtues, si dhe prej zhvillimeve politike në lidhje me ciklet e njëpasnjëshme zgjedhore përgjatë vitit 2025. Për pasojë, nuk u publikua asnjë informatë në lidhje me ecurinë e zotimeve dhe KKB-ja nuk zhvilloi takime.¹⁴ MAPL-ja e pohon mungesën e bashkërendimit me shoqërinë civile dhe të takimeve të KKB-së. Procesi i zbatimit dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile nuk u bashkërenduan nga ndonjë autoritet qendror, por u fragmentua nëpër ministri të ndryshme të linjës dhe institucione të tjera. Nga fundi i periudhës së zbatimit, vëmendja e PK-së dhe e Strukturës së PQH-së kaloi tek procesi i bashkëkrijimit të planit të dytë të veprimit për periudhën 2026-2028 që filloi në tetor 2025 dhe përfundoi në mars 2026.¹⁵

MPR-ja përdor Standardet e PQH-së për Pjesëmarrjen dhe Bashkëkrijimin për të vlerësuar praktikatat pjesëmarrëse të një shteti përgjatë ciklit të planit të veprimit.¹⁶ Shtetet nxiten të synojnë përmbushjen e plotë të standardeve dhe të përmbushin kërkesat minimale të secilit standard.¹⁷

Tabela 2. Përmbushja e Kërkesave Minimale

Kërkesa minimale	Bashkëkrijimi	Zbatimi
1.1 Hapësira për dialog: Komiteti Kombëtar i Bashkërendimit (KKB) u themelua në korrik të vitit 2021¹⁸ dhe mbajti takimin e parë në tetor të vitit 2021.¹⁹ KKB-ja u mbledh 11 herë gjatë bashkë-krijimit të planit të veprimit për periudhën 2023-2025, me katër punëtori tematike dhe shtatë diskutime publike në qendrat kryesore rajonale të Kosovës.²⁰ Siç vërehet nga VPV-ja, përvoja e PK-së së MAPL-së me shoqërinë civile ndihmoi zhvillimin e një procesi bashkë-krijues shumë të hapur dhe me pjesëmarrje²¹ dhe kjo konfirmohet nga shumë të intervistuar prej shoqërisë civile. Pas miratimit të planit të veprimit në dhjetor të vitit 2023, KKB-ja nuk u mbledh përgjatë të tërë fazës së zbatimit dhe nuk u angazhua as shoqëria civile në diskutimet për zbatimin.²² Forumi Kombëtar për Qeverisjen e Hapur, forum shumëpalësh, u krijua në fund të vitit 2025. Ky forum u mbledh disa herë gjatë fundit të vitit 2025 dhe në fillim të vitit 2026 për bashkë-krijimin e planit të dytë të veprimit (2026-2028).	Po	Jo

Kërkesa minimale 1.1 thotë se shtetet në PQH duhet të kenë një hapësirë për dialogun e vazhdueshëm me pjesëmarrje nga qeveria dhe shoqëria civile, e cila mbledhet të paktën çdo gjashtë muaj përgjatë ciklit të planit të veprimit. Duke qenë se hapësira për dialog e Kosovës (KKB-ja) nuk u mbledh të paktën çdo gjashtë muaj përgjatë fazës së zbatimit (dhjetor 2023-dhjetor 2025), MPR-ja vlerëson se kjo kërkesë minimale nuk është përmbushur.		
2.1 Faqja e internetit për PQH-në: Gjatë bashkëkrijimit, u zhvillua një faqe e posaçme (ogpkosovo.org) dhe ajo përmbante planin e veprimit 2023-2025 dhe informacione për procesin e PQH-së. ²³ Kjo faqe nuk ishte funksionale përgjatë pjesës më të madhe të periudhës së zbatimit dhe nuk përditësohej me informacione dhe prova për ecurinë e zotimeve. ²⁴	Po	Jo
2.2 Arkivi: Gjatë fazës së bashkëkrijimit, ogpkosovo.org përmbante materiale të ndryshme rreth procesit të bashkëkrijimit, si përbërja e KKB-së, dokumentet e bashkëkrijimit dhe projekte të ndryshme të planit të veprimit. ²⁵ Në dhjetor të vitit 2023, që përkon me miratimin e planit të veprimit, përditësimi i fundit u bë më 26 korrik 2022. Gjithashtu, nuk u gjetën as procesverbale të mbledhjeve të KKB-së. ²⁶ Përgjatë fazës së zbatimit, kjo faqe nuk u mirëmbajt dhe u bë jo funksionale.	Jo	Jo
3.1 Njoftimet paraprake: Shihni Vlerësimin e Planit të Veprimit ²⁷	Jo	Nuk është i zbatueshëm për këtë zotim.
3.2 Informimi dhe angazhimi i publikut: Shih Vlerësimin e Planit të Veprimit	Po	Nuk është i zbatueshëm për këtë zotim.
3.3 Mekanizmi i kthimit të përgjigjeve: Shih Vlerësimin e Planit të Veprimit	Po	Nuk është i zbatueshëm për këtë zotim.
4.1 Përgjigjja e arsyetuar: Shih Vlerësimin e Planit të Veprimit	Jo	Nuk është i zbatueshëm për këtë zotim.
5.1 Zbatim ende në proces: KKB-ja nuk u mbledh gjatë periudhës së zbatimit dhe nuk pati angazhime të tjera të bashkërenduara me shoqërinë civile për të diskutuar rreth procesit të zbatimit. Për disa prej zotimeve, pati angazhim rast pas rasti të shoqërisë civile me ministrinë e linjës dhe me institucione të tjera. Kërkesa minimale 5.1 u kërkon shteteve të PQH-së të organizojnë të paktën dy takime në vit me shoqërinë civile për të paraqitur rezultatet e zbatimit të planit të veprimit dhe për të mbledhur komente. Duke qenë se këto takime nuk u zhvilluan gjatë fazës së zbatimit të planit të veprimit të Kosovës për periudhën 2023-2025, MPR-ja vlerëson se Kosova nuk e përmbushi këtë kërkesë.	Nuk është i zbatueshëm për këtë zotim.	Jo

¹ Fidan Kalaja (ish-Pika e Kontaktit për Kosovën gjatë procesit të bashkëkrijimit), intervistë me MPR-në, 30 mars 2026.

² Flurim Arifi (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal – MAPL dhe Pika e Kontaktit të PQH-së për Kosovën), intervistë me MPR-në, 24 mars 2026.

³ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Vendim i Qeverisë së Kosovës Nr. 21/178, datë 13 dhjetor 2023, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=84703>

⁴ Partneriteti për Qeverisje të Hapur, Plan i Veprimit për PQH-në Kosovë 2026-2028, mars 2026, https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2026/04/Kosovo_Action-Plan_2026%E2%80%932028_EN.pdf

⁵ Fidan Kalaja (ish-Pika e Kontaktit për Kosovën gjatë procesit të bashkëkrijimit), intervistë me MPR-në, 30 mars 2026.

⁶ Blerta Thaçi (Open Data Kosova – ODK), intervistë me MPR-në, 25 mars 2026.

⁷ Diana Metushi Krasniqi (Instituti Demokratik i Kosovës – IDK), intervistë me MPR-në, 6 prill 2026

⁸ Blerta Thaçi (Open Data Kosova – ODK), intervistë me MPR-në, 25 mars 2026.

⁹ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Krijimi i Komitetit Kombëtar të Bashkërendimit në kuadër të Partneritetit për Qeverisje të Hapur, 29 tetor 2021, <https://bit.ly/3HKRjnK>

¹⁰ Fidan Kalaja (ish-Pika e Kontaktit për Kosovën gjatë procesit të bashkëkrijimit), intervistë me MPR-në, 30 mars 2026.

¹¹ Partneriteti për Qeverisje të Hapur, Vlerësimi i Planit të Veprimit të Kosovës 2023-2025, <https://www.opengovpartnership.org/documents/kosovo-action-plan-review-2023-2025/>

¹² Blerta Thaçi (Open Data Kosova – ODK), intervistë me MPR-në, 25 mars 2026; Diana Metushi Krasniqi (Instituti Demokratik i Kosovës – IDK), intervistë me MPR-në, 6 prill 2026; Valmir Gashi (Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale – KLGI), intervistë me MPR-në, 31 mars 2026.

¹³ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Vendim i Qeverisë së Kosovës Nr. 21/178, datë 13 dhjetor 2023, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=84703>

¹⁴ Blerta Thaçi (Open Data Kosova – ODK), intervistë me MPR-në, 25 mars 2026; Diana Metushi Krasniqi (Instituti Demokratik i Kosovës – IDK), intervistë me MPR-në, 6 prill 2026; Burbuqe Kastrati (Lëvizja Fol), intervistë me MPR-në, 1 prill 2026.

¹⁵ Partneriteti për Qeverisje të Hapur, Kosovë, Plan i Veprimit i Kosovës për PQH-në 2026-2028, mars 2026, https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2026/04/Kosovo_Action-Plan_2026%E2%80%932028_EN.pdf

¹⁶ Partneriteti për Qeverisje të Hapur, Standardet e PQH-së për Pjesëmarrjen dhe Bashkëkrijimin, 2021, <https://www.opengovpartnership.org/ogp-participation-co-creation-standards/>

¹⁷ Partneriteti për Qeverisje të Hapur, Udhëzimet e MPR-së për Vlerësimin e Kërkesave Minimale, 2022, https://www.opengovpartnership.org/wp-content/uploads/2022/05/IRM-Guidelines-for-Assessment-of-Minimum-Requirements_20220531_EN.pdf

¹⁸ Partneriteti për Qeverisje të Hapur, Vlerësimi i Planit të Veprimit të Kosovës 2023-2025, <https://www.opengovpartnership.org/documents/kosovo-action-plan-review-2023-2025/>

¹⁹ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Krijimi i Komitetit Kombëtar të Bashkërendimit në kuadër të Partneritetit për Qeverisje të Hapur, 29 tetor 2021, <https://bit.ly/3HKRjnK>

²⁰ Fidan Kalaja (ish-Pika e Kontaktit për Kosovën gjatë procesit të bashkëkrijimit), intervistë me MPR-në, 30 mars 2026.

²¹ Partneriteti për Qeverisje të Hapur, Vlerësimi i Planit të Veprimit të Kosovës 2023-2025, <https://www.opengovpartnership.org/documents/kosovo-action-plan-review-2023-2025/>

²² Blerta Thaçi (Open Data Kosova – ODK), intervistë me MPR-në, 25 mars 2026; Diana Metushi Krasniqi (Instituti Demokratik i Kosovës – IDK), intervistë me MPR-në, 6 prill 2026; Burbuqe Kastrati (Lëvizja Fol), intervistë me MPR-në, 1 prill 2026.

²³ Partneriteti për Qeverisje të Hapur, Vlerësimi i Planit të Veprimit të Kosovës 2023-2025, <https://www.opengovpartnership.org/documents/kosovo-action-plan-review-2023-2025/>

²⁴ Blerta Thaçi (Open Data Kosova – ODK), intervistë me MPR-në, 25 mars 2026.

²⁵ Blerta Thaçi (Open Data Kosova – ODK), intervistë me MPR-në, 25 mars 2026.

²⁶ Partneriteti për Qeverisje të Hapur, Vlerësimi i Planit të Veprimit të Kosovës 2023-2025, <https://www.opengovpartnership.org/documents/kosovo-action-plan-review-2023-2025/>

²⁷ Partneriteti për Qeverisje të Hapur, Vlerësimi i Planit të Veprimit të Kosovës 2023-2025, <https://www.opengovpartnership.org/documents/kosovo-action-plan-review-2023-2025/>

Kreu IV. Metodologjia

Ky raport mbështet llogaridhënien e shteteve si edhe të mësuarit nëpërmjet vlerësimeve të përmbushjes së planit të veprimit dhe nga rezultatet fillestare. Raporti bën një analizë të thelluar të zotimeve dhe grupimeve për të cilat janë arritur rezultatet më të mira fillestare në planin e veprimit. Ai vlerëson gjithashtu praktikatat pjesëmarrëse dhe bashkëkrijuese të shtetit përgjatë ciklit të planit të veprimit.¹

Produktet e MPR-së që ofrohen përgjatë ciklit të planit të veprimit kombëtar përfshijnë:

- **Dokumentin Përmbledhës për Procesin e Bashkëkrijimit:** Një dokument përmbledhës që thekson mësimet e marra nga raportet e mëparshme të MPR-së për të mbështetur procesin e PQH-së të një shteti, hartimin e planit të veprimit dhe të mësuarit në përgjithësi.
- **Vlerësimi i Planit të Veprimit:** Një vlerësim teknik i karakteristikave të planit të veprimit dhe i pikave të forta dhe sfidave të identifikuara nga MPR-ja që përdoret për të përmirësuar procesin e zbatimit.
- **Vlerësimi i ndërmjetëm:** Një vlerësim i planeve katër vjeçare të veprimit pas një përditësimi në mes të periudhës. Këtu vlerësohen zotimet e reja apo ato të ndryshuara lehtësisht në planin e përditësuar të veprimit dhe përputhshmëria me rregullat e PQH-së, si dhe ofrohen përditësime informale në lidhje me ecurinë e zbatimit.
- **Raporti i Rezultateve:** Një vlerësim i përgjithshëm i zbatimit që përqendrohet tek rezultatet e nivelit të politikave dhe tek mënyra se si ndodhin ndryshimet. Këtu kontrollohet edhe përputhshmëria me rregullat e PQH-së dhe ofrohen informata për të ndihmuar llogaridhënien dhe të mësuarit afatgjatë.

Në pjesën e Raportit të Rezultateve, MPR-ja i vlerëson zotimet në bazë të dy treguesve:

Niveli i përmbushjes

MPR-ja vlerëson shkallën e përmbushjes së secilit zotim në planin e veprimit, duke përfshirë edhe zotimet e grupuara në Vlerësimin e Planit të Veprimit.² Niveli i përmbushjes së të gjitha zotimeve mund të marrë një prej vlerësimeve të mëposhtme:

- Nuk ka prova në dispozicion
- Nuk ka filluar
- E kufizuar
- Në shkallë të konsiderueshme
- Përmbushur plotësisht

Rezultatet Fillestare

MPR-ja vlerëson nivelin e rezultateve fillestare nga zbatimi i secilit zotim apo grupim. Për këtë, MPR-ja merr parasysh objektivat e zotimeve, kontekstin e vendit, fushën e politikave dhe provat e ndryshimeve. Treguesi i Rezultateve Fillestare përcaktohet nga niveli i ndryshimeve dhe nga provat që tregojnë se ndryshimi mund të ruhet me kalimin e kohës. Treguesi i rezultateve fillestare përcakton tre nivele rezultatesh:

- **Nuk ka rezultate të dukshme:** Sipas provave të grumbulluara (nëpërmjet kërkimeve, intervistave, etj.), zbatimi i zotimit për qeverisje të hapur ka dhënë pak ose aspak rezultate pozitive. Pas vlerësimit të veprimtarive të zhvilluara përgjatë periudhës së zbatimit dhe të rezultateve (nëse ka), MPR-ja nuk konstatoi ndryshime me vlerë në lidhje me:

- përmirësimin e praktikave, politikave, ose institucioneve që mbulojnë një fushë politikash apo brenda sektorit publik,
 - përmirësimin e mjedisit mundësues për të ndërtuar besimin ndërmjet qytetarëve dhe shtetit.
- **Rezultate të moderuara:** Sipas provave të grumbulluara (nëpërmjet kërkimeve, intervistave, etj.), zbatimi i zotimit të qeverisjes së hapur ka dhënë rezultate pozitive. Pas vlerësimit të veprimtarive të zhvilluara përgjatë periudhës së zbatimit dhe të rezultateve, MPR-ja gjeti ndryshime me vlerë në lidhje me:
 - përmirësimin e praktikave, politikave, ose institucioneve që mbulojnë një fushë politikash apo brenda sektorit publik, ose
 - përmirësimin e mjedisit mundësues për të ndërtuar besimin ndërmjet qytetarëve dhe shtetit.
 - **Rezultate të konsiderueshme:** Sipas provave të grumbulluara (nëpërmjet kërkimeve, intervistave, etj.), zbatimi i zotimit të qeverisjes së hapur ka dhënë rezultate pozitive të konsiderueshme. Pas vlerësimit të veprimtarive të zhvilluara përgjatë periudhës së zbatimit dhe të rezultateve, MPR-ja gjeti ndryshime me vlerë në lidhje me:
 - përmirësimin e praktikave, politikave, ose institucioneve që mbulojnë një fushë politikash apo brenda sektorit publik, ose
 - përmirësimin e mjedisit mundësues për të ndërtuar besimin ndërmjet qytetarëve dhe shtetit.

Rezultatet pozitive të konsiderueshme tregojnë pritshmëri të qarta që këto ndryshime (të përcaktuara më lart) do të jenë të qëndrueshme edhe me kalimin e kohës.

Ky raport u përgatit nga MPR-ja në bashkëpunim me Taulant Hoxhën dhe është shqyrtuar nga German Emanuelle, eksperte e jashtme e MPR-së. Metodologjia e MPR-së, cilësia e produkteve të MPR-së dhe procesi i shqyrtimit mbikëqyren nga Paneli i Ekspertëve Ndërkombëtarë të MPR-së (PEN).³ Për më shumë informacione, referojuni faqes së internetit të MPR-së⁴ ose fjalorthit të termave të MPR-së dhe PQH-së.⁵

¹ Për përkufizimet e termave të PQH-së, të tilla si bashkë-krijimi dhe zotimet premtuese, shihni Fjalorthin e PQH-së, <https://www.opengovpartnership.org/glossary/>

² MPR-ja i grupon zotimet që kanë të njëjtin objekt politikash gjatë procesit të Vlerësimit të Planit të Veprimit. Në këto raste, MPR-ja vlerëson "Potencialin për Rezultate" dhe "Rezultatet Fillestare" në nivel grupi zotimesh. Përmeshja e zotimeve vlerësohet me shkallë. Për më shumë informacion në lidhje me mënyrën se si MPR-ja i grupon zotimet, shihni Kreun IV për Metodologjinë e Vlerësimit të Planit të Veprimit.

³ Partneriteti për Qeverisje të Hapur, Mekanizmi i Pavarur i Raportimit, Paneli i Ekspertëve Ndërkombëtarë, <https://www.opengovpartnership.org/about/who-we-are/international-experts-panel/>

⁴ Partneriteti për Qeverisje të Hapur, Vështrim i Përgjithshëm i MPR-së, <https://www.opengovpartnership.org/irm-guidance-overview/>

⁵ Partneriteti për Qeverisje të Hapur, Fjalorth i PQH-së, <https://www.opengovpartnership.org/glossary/>

Shtojca I. Të dhëna për zotimet¹

Zotimi 1.1: Portali i shërbimeve elektronike i Kosovës (e-Kosova)

≠ **I verifikueshëm:** Po
 ≠ **A trajtohet nga këndvështrimi i qeverisjes së hapur?** Po
 ≠ **Potenciali për rezultate:** Modest

≠ **Shkalla e përmbushjes:** E kufizuar
 ≠ **Rezultatet fillestare:** Nuk ka rezultate të dukshme

Zotimi 1.1 synonte të zhvillonte një rubrikë të posaçme në platformën e-Kosova për të digjitalizuar proceset për dhënien e granteve dhe subvencioneve. Etapat e planifikuara përqendroheshin tek hartimi dhe miratimi i një Udhëzimi Administrativ të posaçëm për digjitalizimin e granteve dhe subvencioneve, duke krijuar një rubrikë përkatëse për aplikimin për grante në e-Kosova dhe duke përmirësuar kapacitetet e zyrtarëve publikë për përdorimin e këtyre instrumenteve.

Përmbushje ishte e kufizuar. Nuk u hartua dhe nuk u miratua asnjë Udhëzim Administrativ apo akt ligjor relevant. Sidoqoftë, në e-Kosova u krijua një rubrikë e posaçme për "Grantet dhe Subvencionet" që mundëson integrim të pjesshëm të skemave të caktuara të granteve dhe subvencioneve.² Këto skema të integruara kryesisht udhëhiqen nga institucione të nivelit qendror dhe përmbajnë subvencione për faturat e rrymës elektrike për konsumatorët e cenueshëm (program qeveritar i vitit 2024), subvencione për blerjen e librave shkollorë nëpërmjet Ministrisë së Arsimit,³ grante që administrohen nga Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve të Kosovës⁴ dhe disa masa të efikasitetit të energjisë elektrike që zbatohen nga Fondi i Kosovës për Eficiência të Energjisë⁵ dhe nga Ministria e Ekonomisë.⁶ Sipas informacioneve të shpërndara nga Qeveria e Kosovës, rubrika e Grantëve dhe Subvencioneve shënoi 411,000 raste kur këto shërbime elektronike u kërkuar apo aksesuan. Për këto skema, e-Kosova kryesisht mundësoi aplikimet online, por nuk u dhanë informata për publikun lidhur me zbatimin e granteve dhe subvencioneve të akorduara, listën e përfituesve, apo raportet e vlerësimit. Gjithashtu, nuk kishte informacione për ndonjë program për rritjen e kapaciteteve për zyrtarët publikë në lidhje me përdorimin e instrumentit të granteve dhe subvencioneve në e-Kosova. Sidoqoftë, shpërndarësit e rëndësishëm të granteve dhe subvencioneve, si Ministria e Bujqësisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe të gjitha komunat, vijnë t'i shpërndajnë grantet nëpërmjet proceseve dhe platformave të tyre.

Në tërësi, ky zotim paraqitet i përmbushur në shkallë të kufizuar dhe të fragmentuar dhe nuk ka krijuar ende rezultate fillestare të dukshme.

Zotimi 1.2: Integrimi i modulit të ri (e-Komunat) brenda e-Kosovës për të digjitalizuar të gjitha shërbimet komunale

≠ **I verifikueshëm:** Po
 ≠ **A trajtohet nga këndvështrimi i qeverisjes së hapur?** Po
 ≠ **Potenciali për rezultate:** Modest

≠ **Shkalla e përmbushjes:** E kufizuar
 ≠ **Rezultatet fillestare:** Nuk ka rezultate të dukshme

Zotimi 1.2 synonte të integronte modulin e ri e-Komunat brenda portalit e-Kosova. Etapat e

planifikuara ishin digjitalizimi i 50 shërbimeve komunale nëpërmjet e-Komunat, duke përfshirë proceset e nevojshme politike dhe operacionale të digjitalizimit, dhe trajnimi dhe rritja e kapaciteteve për personelin e komunave për të garantuar zbatim dhe përdorim të efektshëm.

Në përgjithësi, pati përmbushje të kufizuar. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) prezantoi e-Komunat në maj të vitit 2024 dhe është aktualisht në fazën e tretë të zbatimit. Shërbimet elektronike u zhvilluan në dy fazat e para: faza e parë u menaxhua nga Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) kurse e dyta u menaxhua nga MAPL-ja, ku për zhvillimin e platformës u kontraktua një kompani jashtë ministrisë. Deri tani, përbëhen nga 10 module shërbimesh elektronike komunale: 1) Transmetimi i drejtpërdrejtë i takimeve të Kuvendit të Komunës; 2) Raportimi i problemeve në komunën tuaj; 3) Komunikimi me zyrtarin komunal; 4) Nisja dhe komentimi në debatet publike në komunën tuaj; 5) Lejet dhe procedurat administrative për Komunën e Prizrenit; 6) Lejet dhe procedurat administrative për Komunën e Lipjanit; 7) Grantet dhe Subvencionet e Komunës; 8) Regjistri i Tatimeve Komunale; 9) Regjistri i Investimeve Kapitale; 10) Regjistri i Pronave të Paluajtshme të Komunave.

Megjithëse nuk pati një Dokument Konceptual të posaçëm për e-Komunat, hartimi i shërbimeve elektronike u bazua në Dokumentin Fillestar, i cili përfshinte të gjitha kriteret për zhvillimin e platformës e-Komunat, duke përfshirë arsyetimin, fazat dhe afatet kohore, pamjen dhe kërkesat funksionale dhe kriteret e përzgjedhjes për kompaninë e kontraktuar.⁷ Platforma nisi pilotimin në tre komuna (Prishtinë, Mitrovicë e Jugut dhe Gjilan), me plane për zgjerim në të gjitha komunat. Përzgjedhja e komunave pilot u krye në konsultim me Asosacionin e Komunave të Kosovës (me zyrtarët e TIK-ut) dhe u organizuan takime paraprake me komunat pilot për të grumbulluar komente për disa module specifike. Në fund të periudhës së zbatimit, ishin zhvilluar të 10 fushat e shërbimit,⁸ por vetëm pak prej tyre janë funksionale dhe të qasshme për publikun: 1) Transmetimi i takimeve të Kuvendit të Komunës, për pak komuna,⁹ ku transmetimi i fundit është i vitit 2024; 2) Raportimi i problemeve në komunën tuaj,¹⁰ dhe 3) Komunikimi me zyrtarin komunal¹¹ ku platformat e të dyjave funksionojnë plotësisht por që nuk ka pasur asnjë rast përgjigjeje nga komunat apo zyrtarët komunalë përkatës;¹² 4) Lejet dhe procedurat administrative në Komunën e Prizrenit,¹³ dhe 5) Lejet dhe procedurat administrative në Komunën e Lipjanit;¹⁴ 6) Regjistri i tatimeve komunale në tre komunat pilot,¹⁵ më informacione të kufizuara për publikun në platformë; dhe 7) Lista e pronave të paluajtshme të komunave në të tre komunat pilot.¹⁶ Disa shërbime nuk janë të disponueshme në platformë, si monitorimi i statusit të procesit të shqyrtimit të akteve të komunës, nisja e peticioneve, pjesëmarrja në debate publike dhe pjesëmarrja në përcaktimin e përparësive të komunës. Raportimet nga qeveria dhe intervistat nxjerrin në pah se burimet njerëzore dhe kapacitetet teknike jo të njëjta nëpër komuna ndikuan tek ritmi dhe njëtrajtshmëria e shtrirjes së shërbimit.

Në lidhje me rritjen e kapaciteteve, në vitin 2025 u organizua një trajnim për personelin e MAPL-së, i cili u vijua nga një trajnim më i thelluar për zyrtarët e komunave më 17–18 dhjetor 2025 në Pejë, organizuar në bashkëpunim me OSBE-në dhe me Asosacionin e Komunave të Kosovës. Nuk është dokumentuar asnjë vlerësim zyrtar i nevojave. Por raportohet se disa nevoja u identifikuan gjatë trajnimit me personelin e komunave në dhjetor 2025.

Në përgjithësi, zotimi shfaq përmbushje të kufizuar dhe nuk ka krijuar ende rezultate fillestare

të dukshme.

Zotimi 1.3: Sistemi online për raportimin dhe vlerësimin e dëmeve të fatkeqësive natyrore

☒ I verifikueshëm: Po ☒ A trajtohet nga këndvështrimi i qeverisjes së hapur? Po ☒ Potenciali për rezultate: Modest	☒ Shkalla e përmbushjes: Nuk ka filluar ☒ Rezultatet fillestare: Nuk ka rezultate të dukshme
--	--

Zotimi 1.3 synonte zhvillimin e një aplikacioni të posaçëm ku qytetarët të regjistronin dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, me vëmendje të veçantë për fermerët.

Provat në dispozicion tregojnë se ky zotim nuk filloi përgjatë periudhës së zbatimit. Raportimi dhe vlerësimi i dëmeve të fatkeqësive natyrore zhvillohet në përputhje me procedurat¹⁷ e parashikuara në Rregulloren e vitit 2015 për metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera,¹⁸ e cila nuk parashikon një sistem raportimi online. Verifikimi në lidhje me përmbytjet e janarit të vitit 2026 konfirmon se qytetarët e dëmtuar ishin udhëzuar që t'i paraqisnin aplikimet fizikisht tek zyrat komunale.¹⁹

Duke pasur parasysh mungesën e progresit, nuk janë vërejtur rezultate fillestare.

Zotimi 2.1: Publikimi i të dhënave qeveritare nëpërmjet Portalit të të Dhënave të Hapura

☒ I verifikueshëm: Po ☒ A trajtohet nga këndvështrimi i qeverisjes së hapur? Po ☒ Ky zotim është grupuar si: Të dhënat e Hapura (Zotimet 2.1-2.4 të planit të veprimit) ☒ Potenciali për rezultate: Modest	☒ Shkalla e përmbushjes: Nuk ka filluar ☒ Rezultatet fillestare: Nuk ka rezultate të dukshme
---	--

Zotimi 2.1 synonte të përmirësonte procedurat e institucioneve publike për përgatitjen, standardizimin dhe publikimin e të dhënave në faqet zyrtare të institucioneve dhe në Portalin e të Dhënave të Hapura. Etapat e planifikuara përfshinin krijimin e Këshillit Strategjik Kombëtar për të monitoruar dhe drejtuar zbatimin e Kartës së të Dhënave të Hapura në Republikën e Kosovës, duke krijuar një grup punë ndërinstitucional për bashkërendimin e zbatimit nga institucionet e ndryshme dhe përcaktimin e afateve për publikimin e të dhënave përkatëse nga ministritë dhe departamentet.

Provat në dispozicion tregojnë se veprimtaritë e parashikuara si pjesë e këtij zotimi nuk filluan gjatë periudhës së zbatimit. Nuk pati përpjekje as për krijimin e Këshillit Strategjik Kombëtar e as të grupit ndërinstitucional të punës për bashkërendimin dhe zbatimin e Kartës së të Dhënave të Hapura në Republikën e Kosovës. Portali i të Dhënave të Hapura u zhvillua në periudhën 2016-2017 nga Open Data Kosova,²⁰ një OJQ civilo-teknike. Që prej prezantimit, portali ka pasur probleme me funksionimin, qasje të paqëndrueshme dhe publikim të kufizuar dhe josistematik të të dhënave.²¹ Portali ka qenë jashtë funksionit për periudha të gjata

kohore, përfshirë periudhën e krijimit të këtij raporti. Sipas një aktivisti të shoqërisë civile, kur ishte funksional për herë të fundit në vjeshtë të vitit 2025, portali thuhet se përmbante 205 grupime të dhënash, kryesisht prej Institutit Hidrogeologjik, Ministrisë së Shëndetësisë dhe prej Ministrisë së Financave.²² Edhe kur portali funksiononte, publikimi i të dhënave ishte i fragmentuar dhe nuk kishte bashkërendim institucional.²³ Nuk ka informacione për ndonjë plan për vënien në funksion të portalit, për rritjen e numrit të grupeve të të dhënave, apo për përmirësimin e cilësisë dhe përdorimit të të dhënave.

Duke pasur parasysh mungesën e progresit, nuk janë vërejtur rezultate fillestare.

Zotimi 2.2: Rritja me 30% e numrit të bazave të të dhënave të publikuara në Portalin e të Dhënave të Hapura

☒ **I verifikueshëm:** Po
 ☒ **A trajtohet nga këndvështrimi i qeverisjes së hapur?** Po
 ☒ Ky zotim është grupuar si: Të dhënat e Hapura (Zotimet 2.1-2.4 të planit të veprimit)
 ☒ **Potenciali për rezultate:** Modest

☒ **Shkalla e përmbushjes:** Nuk ka prova në dispozicion
 ☒ **Rezultatet fillestare:** Nuk ka rezultate të dukshme

Zotimi 2.2 synonte të rriste me 30% numrin e grupeve të të dhënave të publikuara në Portalin e të Dhënave të Hapura. Etapat e planifikuara ishin që institucionet publike të identifikonin grupet e të dhënave që mungojnë, të përcaktonin përparësi të qarta për publikimin e të dhënave nga institucionet dhe të ngarkonin të dhënat që mungonin në portal.

Nuk ka informacione për ndonjë nismë për të identifikuar grupet e të dhënave që mungojnë apo nëse janë publikuar të dhëna të reja përgjatë periudhës së zbatimit. Siç përmendet në pjesën e Zotimit 2.1, portali ka qenë jashtë funksionit për periudha të gjata kohore, përfshirë periudhën e krijimit të këtij raporti. Sipas OSHC-ve që e kanë përdorur portalin kur ishte i qasshëm, janë publikuar disa grupe të reja të dhënash përgjatë periudhës së raportimit, veçanërisht nga Ministria e Financave.²⁴ Sidoqoftë, për arsye të mos funksionimit të portalit dhe të mungesës së reagimit nga institucionet publike përgjegjëse për portalin, MPR-ja nuk mundi ta verifikojë një gjë të tillë.

Për arsye të mungesës së informacioneve rreth zbatimit, nuk janë vërejtur rezultate fillestare.

Zotimi 2.3: Ofrimi i ndihmës (teknike) për zyrtarët publikë për publikimin e të dhënave

☒ **I verifikueshëm:** Po
 ☒ **A trajtohet nga këndvështrimi i qeverisjes së hapur?** Po
 ☒ Ky zotim është grupuar si: Të dhënat e Hapura (Zotimet 2.1-2.4 të planit të veprimit)
 ☒ **Potenciali për rezultate:** Modest

☒ **Shkalla e përmbushjes:** Nuk ka prova në dispozicion
 ☒ **Rezultatet fillestare:** Nuk ka rezultate të dukshme

Zotimi 2.3 synonte ofrimin e ndihmës teknike dhe rritjen e njohurive dhe kapaciteteve të zyrtarëve publikë në lidhje me publikimin e të dhënave të hapura. Nuk ka informacione nëse është ofruar ndonjë lloj ndihme teknike për zyrtarët publikë që merren me publikimin e grupeve të të dhënave në portalin e të dhënave të hapura. Për arsye të mungesës së informacioneve rreth zbatimit, nuk janë vërejtur rezultate fillestare.

Zotimi 2.4: Rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e të dhënave të hapura

☒ **I verifikueshëm:** Po
 ☒ **A trajtohet nga këndvështrimi i qeverisjes së hapur?** Po
 ☒ Ky zotim është grupuar si: Të dhënat e Hapura (Zotimet 2.1-2.4 të planit të veprimit)
 ☒ **Potenciali për rezultate:** Modest

☒ **Shkalla e përmbushjes:** Nuk ka prova në dispozicion
 ☒ **Rezultatet fillestare:** Nuk ka rezultate të dukshme

Zotimi 2.4 synonte rritjen e ndërgjegjësimit të institucioneve publike, shoqërisë civile, medias dhe qytetarëve për rëndësinë e të dhënave të hapura. Etapat e planifikuara ishin organizimi i aktiviteteve për të dhënat e hapura, rritja e sasisë së informacioneve dhe dokumenteve zyrtare që publikohen në mënyrë proaktive, si edhe konceptimi, hartimi, dhe shpërndarja e broshurave dhe materialeve të tjera për publikun për të ndihmuar qytetarët të kuptojnë më mirë vlerën dhe përdorimin e të dhënave të hapura.

Nuk ka informacione për aktivitete, broshura, apo ndonjë lloj tjetër veprimtarie ose materialesh për publikun për të ndihmuar qytetarët të kuptojnë më mirë vlerën dhe përdorimin e të dhënave të hapura. Për arsye të mungesës së informacioneve rreth zbatimit, nuk janë vërejtur rezultate fillestare.

Zotimi 3.1: Përmirësimi i platformave ekzistuese për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje

☒ **I verifikueshëm:** Po
 ☒ **A trajtohet nga këndvështrimi i qeverisjes së hapur?** Po
 ☒ **Potenciali për rezultate:** Modest

☒ **Shkalla e përmbushjes:** E kufizuar
 ☒ **Rezultatet fillestare:** Nuk ka rezultate të dukshme

Zotimi 3.1 synonte përmirësimin e platformave ekzistuese për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje. Etapat e planifikuara përfshinin krijimin e mekanizmave për mbikëqyrjen e zbatimit të Udhëzimit Administrativ për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, krijimin e mekanizmave për mbikëqyrjen e zbatimit të Rregullores për standardet minimale të procesit të konsultimit publik dhe organizimin e aktiviteteve për rritjen e kapaciteteve të zyrtarëve publikë për të mbështetur përmbushjen e vazhdueshme të standardeve, si edhe përmirësimin e cilësisë së pjesëmarrjes publike në institucione.

Provat në dispozicion tregojnë përmbushje të kufizuar. Udhëzimi Administrativ i mëparshëm për Standardet Minimale të Konsultimit Publik është brendësuar në Udhëzimin Administrativ për Administratën e Hapur në Komuna, me ndryshime të dispozitave që ishin kundërshtuar, dhe MAPL-ja thotë se kjo ka përmirësuar zbatimin në praktikë nga ana e komunave.²⁵ Përvec

mandatit ligjor të Seksionit për Transparencë në Komuna për përkrahjen e transparencës dhe llogaridhënies së pushtetit lokal,²⁶ nuk ka pasur mekanizëm të ri për mbikëqyrjen e zbatimit. MAPL-ja vlerëson se kjo kornizë mundëson përfshirjen aktive të qytetarëve në vendimarrjen lokale dhe se tregon një tendencë kryesisht pozitive të transparencës për periudhën 2024–2025, ku komunat gjithnjë e më shumë hartojnë plane për konsultimin publik dhe publikojnë njoftime, hartojnë propozime dhe raporte konsultimi. Në këtë periudhë, MAPL-ja ndau disa dokumente model me komunat, duke përfshirë planin e veprimit për transparencën, projekt-rregulloren për transparencën, modelin e projekt-raportit vjetor për transparencën dhe manualin e buxhetit me pjesëmarrje. Sidoqoftë, OSHC-të që merren me pjesëmarrjen e qytetarëve në nivelin lokal theksojnë se, pavarësisht kornizës ligjore formale që kërkon raportim vjetor prej komunave, monitorim në nivel ministrie dhe monitorim të menaxhimit të punës, ky monitorim vijon të jetë e dobët dhe jo i njëtrajtshëm: Monitorimi i 28 komunave nga KLGJ-ja në vitin 2024 vërejti se raportet e konsultimit publik ishin të disponueshme vetëm në 17 komuna (61 përqind), ndërsa një burim tjetër që monitoron të dhënat e punës propozon një normë edhe më të ulët në nivelin 32.95 përqind në 34 komuna.²⁷ Proceset e konsultimit publik në nivelin lokal janë integruar si me Platformën Online për Konsultimin Publik²⁸ edhe me Raportet Vjetore përkatëse,²⁹ por ende jo në mënyrë të plotë dhe sistematike. Shoqëria civile vëren gjithashtu se platforma për konsultimin publik nuk funksiononte në pjesën më të madhe të vitit 2024, se konsultimet në nivelin lokal shpeshherë ishin formale dhe se monitorimi ka qenë administrativ dhe i fragmentuar, pa u kthyer në mekanizëm të fortë dhe funksional për llogaridhënien.³⁰

Në nivel qendror, Rregullorja për Standardet Minimale të Konsultimit Publik³¹ u integrua në vitin 2024 në Rregulloren e re të Punës së Qeverisë,³² në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet Kryeministrit dhe shoqërisë civile, duke marrë me vete kërkesat ekzistuese dhe duke përfunduar detyrimin për botimin e raporteve përfundimtare të konsultimit.³³ Sipas të dhënave të qeverisë, institucionet qendrore botuan 259 dokumente për konsultim publik në vitin 2024; vetëm 52 prej tyre morën komente nga publiku (gjithsej 170 komente) dhe 57 përqind u shoqëruan me raport përfundimtar të konsultimit.³⁴ Sidoqoftë, shoqëria civile vlerëson se konsultimi publik në nivelin qendror vijon të jetë përgjithësisht formal, me konsultime online me shkrim që shpesh zhvillohen në fazat e fundit të politikëbërjes, duke qenë gati i vetmi kanal për angazhimin e publikut. Kjo e ngushton pjesëmarrjen e qenësishme në një numër të vogël organizatash të konsoliduara, me kapacitetin për të shqyrtuar projekte të ndërlikuara dhe për të paraqitur komente brenda një afati të shkurtër.³⁵ Gjithashtu, problemet me funksionimin dhe periudhat e gjata të mungesës së qasjes kanë ulur ndjeshëm përdorimin e efektshëm të Platformës Online për Konsultimin Publik si instrument për pjesëmarrjen e qytetarëve, pavarësisht raportimit të Zyrës për Qeverisjen e Mirë se është kontraktuar një ekspert i jashtëm për të përmirësuar platformën.

Në lidhje me rritjen e kapaciteteve, nuk pati programe të rregullta trajnime për procesin e konsultimit publik për zyrtarët publikë në nivelin qendror apo lokal. Sidoqoftë, gjatë periudhës së raportimit, ka pasur disa trajnime dhe punëtori për rritjen e kapaciteteve të organizuara me ndihmën e organizatave ndërkombëtare dhe shoqërisë civile, të tilla si punëtoritë/tryezat e rrumbullakëta të mbështetura nga OSBE-ja, të cilat trajtonin funksionimin e platformës, integrimin me faqet e komunave dhe sfidat e transparencës digjitale,³⁶ një trajnim dy-ditor për zyrtarët e komunikimit publik të komunave i organizuar nga projekti DEMOS dhe seancat e punës dhe diskutimet e KLGJ-së në lidhje me raportet e monitorimit.³⁷ Më tej, OJQ-të

organizuan programe të rregullta trajnimi për konsultimin publik për përfaqësuesit e shoqërisë civile.³⁸

Në përgjithësi, zotimi shfaq përmbushje të kufizuar dhe nuk ka krijuar ende rezultate fillestare të dukshme.

Zotimi 3.2: Fushata për parandalimin e përhapjes së padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP)

☒ **I verifikueshëm:** Po
 ☒ **A trajtohet nga këndvështrimi i qeverisjes së hapur?** Po
 ☒ **Potenciali për rezultate:** Modest

☒ **Shkalla e përmbushjes:** E kufizuar
 ☒ **Rezultatet fillestare:** Nuk ka rezultate të dukshme

Zotimi 3.2 synonte parandalimin e përhapjes së padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP). Etapat e planifikuara përfshinin miratimin dhe harmonizimin me Direktivën e ardhshme Anti-SLAPP të BE-së, pjesëmarrjen e institucioneve përkatëse në tryeza të rrumbullakëta dhe konferenca që trajtojnë rreziqet dhe reagimet ndaj Padive SLAPP dhe mbështetjen e OSHC-ve për hartimin dhe zbatimin e fushatave anti-SLAPP.

Progresi ishte i kufizuar. Përgjatë periudhës së raportimit, nuk ka prova për ndonjë nismë zyrtare nga Qeveria e Kosovës për të transpozuar Direktivën Anti-SLAPP të BE-së në ligjin vendas. Sipas shoqërisë civile, Kosova nuk i përmbush standardet thelbësore të përcaktuara nga Direktiva Anti-SLAPP e BE-së.³⁹ Nuk ka një sistem të konsoliduar për grumbullimin dhe publikimin e të dhënave për Paditë SLAPP, nuk ka sanksione të posaçme shkurajuese për nismëtarët e Padive SLAPP dhe nuk ka mekanizma të qartë ligjorë për hedhjen poshtë të këtyre padive në një fazë të hershme të procedurës.⁴⁰ Gjithashtu, nuk ka raste kur gjykatat të kenë identifikuar në mënyrë të shprehur ndonjë rast si Padi SLAPP dhe ta kenë refuzuar që në fazat e hershme të procedurës, duke e bërë të vështirë nxjerrjen sistematike të të dhënave.⁴¹ Një gjë e mirë është që Këshilli Gjyqësor i Kosovës i ka përcaktuar Paditë SLAPP si përparësi për çështjet civile në Planin Strategjik për Qasje në Drejtësi për periudhën 2026–2028.⁴²

Në lidhje me ndërgjegjësimin dhe rritjen e kapaciteteve, veprimtaritë u nxitën kryesisht prej shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë. Lëvizja FOL, një OJQ vendore që është edhe anëtare e koalicionit kundër Padive SLAPP në Evropë, ka botuar një Doracak për Paditë SLAPP, për profesionistët e fushës së drejtësisë,⁴³ dhe një tjetër për shoqërinë civile dhe median,⁴⁴ si dhe ka nisur krijimin e Grupit Kombëtar kundër Padive SLAPP,⁴⁵ si mekanizëm bashkëpunimi informal ndërmjet shoqërisë civile, medias, sistemit të drejtësisë dhe partnerëve ndërkombëtarë. Instituti i Kosovës për Drejtësi, një OJQ vendore që punon me sistemin e drejtësisë së Kosovës, ia kushtoi një prej debateve mediatike temës së Padive SLAPP.⁴⁶ Këshilli i Evropës dhe Akademia e Drejtësisë së Kosovës pilotuan trajnime të posaçme për Paditë SLAPP për gjyqtarët dhe prokurorët në vitin 2024⁴⁷ dhe 2025,⁴⁸ dhe organizuan një konferencë të posaçme për mënyrën se si mundet gjyqësori të mbrojë lirinë e medias duke iu kundërvënë Padive SLAPP.⁴⁹ Sipas shoqërisë civile, megjithëse gjyqtarët dhe profesionistët e tjerë të drejtësisë kanë marrë pjesë rregullisht në aktivitete të tilla ndërgjegjësimi dhe rritjeje të kapaciteteve, nuk ka pasur pjesëmarrje aktive nga institucione të tjera relevante të qeverisë.⁵⁰ Po ashtu, nuk pati nisma të institucioneve publike për të mbështetur ndonjë fushatë anti-SLAPP nga ana e shoqërisë civile,⁵¹ por shoqëria civile tregon

me shqetësim raste kur aktorë politikë të partisë në pushtet kanë përdorur apo kanë kërcënuar se do të përdorin padi të tipit SLAPP.⁵²

Pavarësisht veprimtarisë së qenësishme nga shoqëria civile dhe organizatat ndërkombëtare, mungesa e angazhimit të fortë institucional përgjatë periudhës së raportimit bëri që në praktikë të mos kemi rezultate fillestare.

Zotimi 3.3: Mekanizma për ankesat e qytetarëve për shërbimet publike

€ **I verifikueshëm:** Po
 € **A trajtohet nga këndvështrimi i qeverisjes së hapur?** Po
 € **Potenciali për rezultate:** I paqartë

€ **Shkalla e përmbushjes:** Nuk ka prova në dispozicion
 € **Rezultatet fillestare:** Nuk ka rezultate të dukshme

Zotimi 3.3 synonte krijimin e mekanizmave për qytetarët për paraqitjen e ankesave dhe marrjen e reagimeve në lidhje me shërbimet e institucioneve publike. Etapat e planifikuara përfshinin prezantimin e instrumenteve digjitale, si një aplikacion për celular, për t'u lejuar qytetarëve t'u komunikojnë komentet e tyre vlerësuese (feedback) drejtpërdrejt institucioneve përkatëse, shoqëruar me fushata promovuese dhe me rritje të kapaciteteve për personelin e institucioneve në lidhje me përdorimin e efektshëm të këtij instrumenti.

Nuk ka informacione që të jetë krijuar ndonjë instrument digjital ose që të jetë organizuar ndonjë fushatë promovuese apo aktivitete për rritjen e kapaciteteve.

Për arsye të mungesës së informacioneve rreth zbatimit, nuk janë vërejtur rezultate fillestare.

Zotimi 4.1: Sistem plotësisht i hapur i prokurimit publik

€ **I verifikueshëm:** Po
 € **A trajtohet nga këndvështrimi i qeverisjes së hapur?** Po
 € **Potenciali për rezultate:** Modest

€ **Shkalla e përmbushjes:** E kufizuar
 € **Rezultatet fillestare:** Nuk ka rezultate të dukshme

Zotimi 4.1 synonte të dhënat e hapura në të gjithë ciklin e prokurimit, që nga periudha përpara tenderit dhe asaj pas tenderit, në format të lexueshëm nga makina, në përputhje me parimet e kontraktimit të hapur. Etapat e planifikuara ishin shqyrtimi i defekteve ekzistuese të prokurimit publik nëpërmjet punëtorive dhe/ose grupeve të punës, miratimi i një Ligji të ri për Prokurimet Publike dhe i mekanizmave për monitorimin e zbatimit dhe zhvillimi i rregullave, instrumenteve dhe udhëzimeve të reja për të mundësuar një sistem elektronik prokurimi që mundet të botojë informacione prokurimi të lexueshme nga makineritë.

Progresi ka qenë i kufizuar. Pjesa e parë që ka të bëjë me reformën legjislativë nuk ka përparuar, pavarësisht punës së vazhdueshme të Ministrisë së Financave për hartimin e një Ligji të ri për Prokurimin Publik. Në fillim, grupi i punës që u krijua në vitin 2022 nuk arriti të përparonte me ligjin e ri⁵³ dhe e njëjta gjë ndodhi me variantin e ri që u nda drejtpërsëdrejti nga Ministria e Financave në dhjetor të vitit 2024. Përfaqësuesit e shoqërisë civile e përshkruajnë procesin si jotransparent dhe me dokumentim të dobët, ku raportohet se nuk janë pasqyruar komentet e shoqërisë civile, nuk janë organizuar konsultime publike dhe se në

fund projektligji nuk ka mbërritur tek qeveria për miratim.⁵⁴

Në mungesë të reformës ligjore, edhe progresi i platformës së hapur elektronike të prokurimit ishte i kufizuar. Korniza ligjore në fuqi është hartuar për një sistem fizik prokurimi dhe Platforma elektronike ekzistuese përballet me vështirësi serioze për arsye të kornizës ligjore të vjetruar. Platforma ekzistuese elektronike e prokurimit nuk ofron në praktikë qasje “të lexueshme nga makinat”, pasi dokumentet kryesore (dokumentacioni i tenderit, vendimet për ankesat, kontratat dhe çmimet) publikohen ende në formatin PDF, shpesh të skanuara dhe me cilësi të keqe, duke ulur kështu përdorimin dhe ripërdorimin.⁵⁵ Një gjë e mirë është që u arrit një etapë e rëndësishme me ndërlidhjen e sistemit elektronik të prokurimit me Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës, i cili është aktualisht i ndërveprueshëm (SIMFK),⁵⁶ si edhe me platformën e procesit të ankesave. Kjo parandalon iniciimin e prokurimit pa u bërë fillimisht alokimi i fondeve, mundëson gjurmueshmëri më të mirë të pagesave dhe pezullon proceset e prokurimit gjatë kohës që procesi i ankimit është në vijim, duke përmirësuar kështu integritetin e menaxhimit të fondeve publike dhe transparencën e shpenzimeve publike.⁵⁷ Në të njëjtën kohë, shoqëria civile shpreh shqetësime serioze në lidhje me besueshmërinë dhe sigurinë e sistemit. Këto shqetësime u shfaqën së fundi gjatë një ndërprerjeje të raportuar të sistemit në vitin 2025, kur masat mbrojtëse rezervë rezultuan të pamjaftueshme.⁵⁸

Pavarësisht se ishte identifikuar si zotim “premtues” në Vlerësimin e Planit të Veprimit të MPR-së, në mungesë të reformës së politikave dhe me përmirësime të sistemit të kufizuara të ndërveprueshmëria e sistemit e-Procurement me disa sisteme të tjera, nuk ka rezultate të dukshme.

Zotimi 4.2: Rekrutimi transparent i zyrtarëve të nivelit të lartë

☒ **I verifikueshëm:** Po
☒ **A trajtohet nga këndvështrimi i qeverisjes së hapur?** Po
☒ **Potenciali për rezultate:** Modest

☒ **Shkalla e përmbushjes:** Në shkallë të konsiderueshme
☒ **Rezultatet fillestare:** Jo të dukshme

Ky zotim vlerësohet në Kreun II më lart.

Zotimi 4.3: Rritja e transparencës, llogaridhënies dhe kontrollit financiar të partive politike të regjistruara në Republikën e Kosovës

☒ **I verifikueshëm:** Po
☒ **A trajtohet nga këndvështrimi i qeverisjes së hapur?** Po
☒ **Potenciali për rezultate:** Modest

☒ **Shkalla e përmbushjes:** E kufizuar
☒ **Rezultatet fillestare:** Nuk ka rezultate të dukshme

Zotimi 4.3 synonte të rriste transparencën, llogaridhënien dhe mbikëqyrjen financiare të partive politike të regjistruara në Kosovë. Etapat e planifikuara ishin shqyrtimi dhe përfundimi i ndryshimeve të bazës ligjore që mbulon financimin e partive politike për të fuqizuar transparencën dhe ligjzbatimin, digjitalizimi i raportimit për të ardhurat dhe shpenzimet e partive nëpërmjet krijimit dhe funksionimit të një platforme online për financat e partive politike, mbështetja e avokimit dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe me median për të

nxitur raportimin e keqpërdorimeve të mundshme dhe monitorimi i shpenzimeve financiare të partive politike përgjatë ciklit zgjedhor të vitit 2025 në nivelin qendror dhe atë lokal.

Gjatë periudhës 2024-2025 nuk pati progres në reformën ligjore, pasi nuk u miratuan ndryshime ligjore dhe nuk pati ndonjë proces relevant për ndryshimin e Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike apo Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Ligji i vitit 2023 për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili u zbatua për herë të parë në zgjedhjet e shkurtit të vitit 2025, prodhoi disa përmirësime procedurale, si krijimi i Zyrës për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar (ZRCKF) pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), por megjithatë nuk përmblente ndryshime thelbësore të rregullave për financimin e partive politike dhe të fushatave zgjedhore.⁵⁹ Pas zbatimit për herë të parë të këtij ligji në Zgjedhjet për Kuvend të datës 9 shkurt 2025, ZRCKF-ja zhvilloi disa rekomandime të brendshme për ndryshime ligjore, përfshirë lejin e një llogarie të posaçme bankare për partitë politike për qëllim të fushatës, duke u kërkuar kandidatëve politikë të raportojnë të ardhurat dhe shpenzimet e fushatës dhe duke caktuar kufijtë e kontributeve.⁶⁰

Nuk ka platformë online për raportimin e financave të partive politike. Në fund të vitit 2024, KQZ-ja mori një platformë softuerike në formë donacioni, por nuk e prezantoi pasi nuk ishte plotësisht funksionale dhe i mungonte pjesa e publikimeve online.⁶¹ Ndërkohë, materialet vijojnë të shpërndahen kryesisht në format PDF dhe KQZ-ja publikon raporte të ndryshme në faqen zyrtare, duke përfshirë raporte tremujore për partitë politike parlamentare,⁶² raporte financiare vjetore të partive politike të regjistruara⁶³ dhe raporte financiare të fushatës zgjedhore.⁶⁴

Pavarësisht se vërehet gatishmëri për bashkëpunim me shoqërinë civile dhe qasje në të dhënat e KQZ-së,⁶⁵ rrjetet kryesore të OSHC-ve që merren me monitorimin e zgjedhjeve nuk kanë gjetur program apo financim të posaçëm institucional për të mbështetur monitorimin e OSHC-ve dhe të medias, që vijon të mbështetet kryesisht nga donatorët ndërkombëtarë.⁶⁶ BE-ja pasqyron shqetësime të ngjashme në lidhje me mungesën e raportimit financiar të ndërmjetëm dhe me mungesën e rregullimit të financimit të palëve të treta.⁶⁷

Monitorimi i tre cikleve të zgjedhjeve të mbajtura në vitin 2025 (dy zgjedhje për kuvendin dhe një për pushtetin lokal i zhvilluar në dy faza) nga KQZ-ja përqendrohej tek veprimtaritë e fushatës dhe nuk përfshinte posaçërisht shpenzimet financiare të partive politike, të cilat mbulohen vetëm me vetëdeklarimin e partive politike.⁶⁸ Por shoqëria civile vijoi të monitoronte shpenzimet financiare gjatë zgjedhjeve dhe provat e monitorimit në vitin 2025 tregojnë që shpenzimet gjatë fushatës u rritën dhe u bënë edhe më komplekse, veçanërisht online, ku pati shpenzime të mëdha që lidhen me kandidatët si individë dhe me disa reklama nga palë të treta. Kjo thekson vështirësitë e vazhdueshme për raportimin në kohë, transparencën në kohë reale dhe kontrollin e financimit të palëve të treta dhe të fushatës digjitale.⁶⁹

Pavarësisht se u identifikua si zotim "premtues" në Vlerësimin e Planit të Veprimit të MPR-së, mungesa e progresit si me reformën ligjore, ashtu edhe me zhvillimin e platformës online, bëri që në praktikë të mos kemi rezultate fillestare.

¹ Shënime redaksionale:

1. Për zotimet e grupuara, vlerësimi i potencialit për rezultate dhe rezultate fillestare zhvillohet në nivel grupi dhe jo në nivel zotimesh individuale.
2. Titujt e shkurtër të zotimeve mund të jenë ndryshuar për qëllime estetike. Për tekstin e plotë të zotimeve, ju lutemi shihni planin e veprimit të Kosovës: <https://www.opengovpartnership.org/documents/kosovo-action-plan-2023-2025-december/>
3. Për më shumë informacione për vlerësimin e hartimit të zotimeve, shihni Vlerësimin e Planit të Veprimit të Kosovës: <https://www.opengovpartnership.org/documents/kosovo-action-plan-review-2023-2025/>
- ² Platforma Shtetërore e-Kosova, Rubrika për Grantet dhe Subvencionet, <https://ekosova.rks-gov.net/Service/32>
- ³ Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Njoftim nga Ministria e Arsimit, 15 gusht 2025, <https://mash.rks-gov.net/news/njoftim-71/>
- ⁴ KIESA, Thirrje Publike për mbështetje financiare për NVM-të në sektorin TIK, 19 qershor 2025, <https://kiesa.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,5,978>
- ⁵ Fondi i Kosovës për Efijencë të Energjisë, FKEE hap aplikimin për subvencionim të masave të efijencës së energjisë për banesa, projekt i mbështetur nga BE-ja, 27 gusht 2024, <https://fkee-rks.net/fkee-hap-aplikimin-per-subvencionim-te-masave-te-efiencies-se-energjise-per-shtepi-te-banimit-projekt-ky-i-mbeshtetur-nga-be/>
- ⁶ Ministria e Ekonomisë, Ministria e Ekonomisë hap Thirrjen për Subvencionim e Pajisjeve për Ngrohje me Efikasitet për Shtëpitë e Banimit, 22 shtator 2024, <https://me.rks-gov.net/en/blog/ministry-of-economy-opens-the-call-for-subsidy-of-efficient-heating-equipment-for-households/>
- ⁷ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Kërkesa Nismëtare për e-Komunat, 15 mars 2023, dokument i brendshëm i shpërndarë MPR-së.
- ⁸ Flurim Arifi (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal – MAPL dhe Pika e Kontaktit të PQH-së për Kosovën), intervistë me MPR-në, 24 mars 2026.
- ⁹ e-Kosova/e-Komuna, Transmetimi i drejtpërdrejtë i takimeve të Kuvendit të Komunës, <https://ekosova.rks-gov.net/Public/444>
- ¹⁰ e-Kosova/e-Komuna, Raportimi i problemeve në komunën tuaj, <https://ekosova.rks-gov.net/Public/444>
- ¹¹ e-Kosova/e-Komuna, Komunikimi me zyrtarin komunal, <https://ekosova.rks-gov.net/448>
- ¹² Flurim Arifi (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal – MAPL dhe Pika e Kontaktit të PQH-së për Kosovën), intervistë me MPR-në, 24 mars 2026.
- ¹³ e-Kosova/e-Komuna, Lejet dhe procedurat administrative për Komunën e Prizrenit, <https://ekosova.rks-gov.net/Public/313>
- ¹⁴ e-Kosova/e-Komuna, Lejet dhe procedurat administrative për Komunën e Lipjanit, <https://ekosova.rks-gov.net/Public/314>
- ¹⁵ e-Kosova/e-Komuna, Regjistri i tatimeve komunale, <https://ekosova.rks-gov.net/551>
- ¹⁶ e-Kosova/e-Komuna, Regjistri i pronave të paluajtshme të komunave, <https://ekosova.rks-gov.net/549>
- ¹⁷ Elheme Hetemi (Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural MBPZHR), korrespondencë me MPR-në, 2 prill 2026.
- ¹⁸ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Rregullore (QRK) Nr. 17/2015, për metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, <https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=35698>
- ¹⁹ Faqe të ndryshme Facebook-u të Komunave, Njoftimet për hapjen e periudhës së aplikimit për vlerësimin e dëmeve nga përmbytjet në Komunitat Skenderaj, <https://www.facebook.com/share/p/1CbTvVXh2y/>, Drenas <https://www.facebook.com/share/p/1CAjo946rj/>, dhe Rahovec <https://www.facebook.com/share/p/1H5CrgBzya/>, 8 dhe 9 janar 2026.
- ²⁰ Open Data Kosova, Portali i të Dhënave të Hapura, <https://opendatakosovo.org/portfolio/open-government-data-portal/>
- ²¹ Blerta Thaçi (Open Data Kosova – ODK), intervistë me MPR-në, 25 mars 2026.
- ²² Diana Metushi Krasniqi (Instituti Demokratik i Kosovës – IDK), intervistë me MPR-në, 6 prill 2026
- ²³ Blerta Thaçi (Open Data Kosova – ODK), intervistë me MPR-në, 25 mars 2026.
- ²⁴ Diana Metushi Krasniqi (Instituti Demokratik i Kosovës – IDK), intervistë me MPR-në, 6 prill 2026
- ²⁵ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) – Departamenti për Qeverisjen e Mirë në nivelin lokal, korrespondencë me MPR-në, 27 mars 2026.
- ²⁶ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) – Departamenti për Qeverisjen e Mirë në nivelin lokal, <https://mapl.rks-gov.net/qeverisje-e-mire-ne-nivel-lokal/>
- ²⁷ Valmir Gashi (Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale – KLGI), intervistë me MPR-në, 31 mars 2026.
- ²⁸ Platforma Online për Konsultimin Publik – Institucionet Lokale, <https://konsultimet.rks-gov.net/institutions.php>
- ²⁹ Zyra për Qeverisjen e Mirë, Kryeministria, Raport Vjetor për konsultimin publik gjatë vitit 2024, mars 2025, <https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Docs/Doc-6821ed93cb654.pdf>
- ³⁰ Eugen Cakolli (Instituti Demokratik i Kosovës – IDK), intervistë me MPR-në, 1 prill 2026.
- ³¹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Rregullore (QRK) Nr. 05/2016 Për Standardet Minimale të Konsultimit Publik, <https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15036>

- ³² Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Rregullore (QRK) - Nr.17/2024 Për Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës, <https://qzk.rks-qov.net/ActDetail.aspx?ActID=92322>
- ³³ Dren Puka (Fondacioni Kosovar për Shoqërinë Civile (FKSC), intervistë me MPR-në, 31 mars 2026.
- ³⁴ Zyra për Qeverisjen e Mirë, Kryeministria, Raport Vjetor për konsultimin publik gjatë vitit 2024, mars 2025, <https://konsultimet.rks-qov.net/Storage/Docs/Doc-6821ed93cb654.pdf>
- ³⁵ Dren Puka (Fondacioni Kosovar për Shoqërinë Civile (FKSC), intervistë me MPR-në, 31 mars 2026.
- ³⁶ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) – Departamenti për Qeverisjen e Mirë në nivelin lokal, korrespondencë me MPR-në, 27 mars 2026.
- ³⁷ Valmir Gashi (Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale – KLGI), intervistë me MPR-në, 31 mars 2026.
- ³⁸ KCSF
- ³⁹ Bashkimi Evropian, Direktiva (EU) 2024/1069 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, 11 prill 2024 (Direktiva Anti-SLAPP e BE-së), <https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2024/1069/oj/eng>
- ⁴⁰ Burbuqe Kastrati (Lëvizja Fol), intervistë me MPR-në, 1 prill 2026.
- ⁴¹ Betim Musliu (Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD), intervistë me MPR-në, 7 prill 2026.
- ⁴² Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Plani Strategjik për përmirësimin e qasjes në drejtësi 2026-2028, https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/2026/01/KGJK_Plani_Strategjik_per_Qasje_ne_Drejttesi_2026_2028.pdf
- ⁴³ Lëvizja Fol, Doracak për Paditë SLAPP për profesionistët e drejtësisë: gjyqtarët, prokurorët, avokatët, policinë dhe për aktorë të tjerë të sistemit të drejtësisë, 2025, <https://levizjafol.org/wp-content/uploads/2025/02/89-Doracak-Padite-SLAPP-ALB03.pdf>
- ⁴⁴ Lëvizja Fol, Doracak për Paditë SLAPP për OJQ-të, gazetarët, aktivistët dhe profesionistët e tjerë të medias, 2025, <https://levizjafol.org/wp-content/uploads/2025/02/88-Padite-Slapp-ALB05.pdf>
- ⁴⁵ Lëvizja Fol, Paditë SLAPP në Kosovë – Harmonizimi me standardet e Këshillit të Evropës dhe të BE-së, artikull, 18 shtator 2025, <https://levizjafol.org/padite-slapp-ne-kosove-harmonizimi-me-standardet-e-keshillit-te-evropes-dhe-be-se/>
- ⁴⁶ Betimi për Drejtësi, TEMPUS, Paditë ndaj kritikës, Debat Mediatik, 26 janar 2026, <https://betimiperdrejttesi.com/live-ne-tempus-padite-ndaj-kritikes/>
- ⁴⁷ Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë, faqja e Facebook-ut, 3 tetor 2024, <https://www.facebook.com/share/p/1DMpezBZ1c/>
- ⁴⁸ Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë, faqja e Facebook-ut, 11 prill 2025, <https://www.facebook.com/share/p/14T76aA1D2Z/>
- ⁴⁹ Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë, faqja e Facebook-ut, 17 qershor 2025, <https://www.facebook.com/share/p/14aDf3Amm91/>
- ⁵⁰ Burbuqe Kastrati (Lëvizja Fol), intervistë me MPR-në, 1 prill 2026.
- ⁵¹ Burbuqe Kastrati (Lëvizja Fol), intervistë me MPR-në, 1 prill 2026.
- ⁵² Betim Musliu (Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD), intervistë me MPR-në, 7 prill 2026.
- ⁵³ Iniciativa për Progres – INPO; INPO, IKD dhe Lëvizja Fol organizuan tryezën e diskutimit “Çka po ndodh me projektligjin për prokurim publik?”, 20 shkurt 2024, <https://new.inpo-ks.org/inpo-ikd-dhe-levizja-fol-mbajten-tryezen-e-diskutimit-cka-po-ndodh-me-projektligjin-per-prokurim-publik/>
- ⁵⁴ Albulena Nrecaj (Iniciativa për Progres – INPO), intervistë me MPR-në, 26 mars 2026.
- ⁵⁵ Albulena Nrecaj (Iniciativa për Progres – INPO), intervistë me MPR-në, 26 mars 2026.
- ⁵⁶ Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën, 2025, 4 nëntor 2025, https://enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2025_en
- ⁵⁷ Diana Metushi Krasniqi (Instituti Demokratik i Kosovës – IDK), intervistë me MPR-në, 6 prill 2026
- ⁵⁸ Albulena Nrecaj (Iniciativa për Progres – INPO), intervistë me MPR-në, 26 mars 2026.
- ⁵⁹ Eugen Cakolli (Instituti Demokratik i Kosovës – IDK), intervistë me MPR-në, 1 prill 2026.
- ⁶⁰ Mergita Kryeziu (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Njësia për Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike), korrespondencë me MPR-në, 30 mars 2026.
- ⁶¹ Mergita Kryeziu (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Njësia për Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike), korrespondencë me MPR-në, 30 mars 2026.
- ⁶² Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Raportet Financiare Tre-mujore, <https://kqz-ks.org/raportet-financiare-tremujore/>
- ⁶³ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Raportet Financiare Vjetore, <https://kqz-ks.org/sherbime-per-subjektet-politike/raportet-vjetore-financiare-te-audituar/>
- ⁶⁴ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Raportet Financiare të Fushatës Zgjedhore, <https://kqz-ks.org/sherbime-per-subjektet-politike/raportet-financiare-te-fushatave-zgjedhore-te-audituar/>
- ⁶⁵ Mergita Kryeziu (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Njësia për Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike), korrespondencë me MPR-në, 30 mars 2026.
- ⁶⁶ Eugen Cakolli (Instituti Demokratik i Kosovës – IDK), intervistë me MPR-në, 1 prill 2026.

⁶⁷ Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën, 2025, 4 nëntor 2025, https://enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2025_en

⁶⁸ Mergita Kryeziu (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Njësia për Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike), korrespondencë me MPR-në, 30 mars 2026.

⁶⁹ Eugen Cakolli (Instituti Demokratik i Kosovës – IDK), intervistë me MPR-në, 1 prill 2026.